



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1169/ 19 prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M

Nr. 919/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-75738-02-10-2026, me objekt: Loti I “Blerje mish viçi dhe mish pule”, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 72,673,488 (shtatëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 753,483.55 (shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e pesë) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 10.02.2026 është 96.45 lekë, zhvilluar më datë 24.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Argent Daci” P.F me NIPT L01914003T dhe adresë: Rruga “Abdi Bej Toptani”, Godina Nr.21, poshtë kthesës së Valiasit, Kamëz, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:	Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë. Adresa: Rruga “Barikadave”, Tiranë.
Subjekti i Interesuar:	Operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK me NIPT K73609801E dhe adresë: Fshati Kanaparaj, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale Nr. 2071, Pasuria Nr.744, Golem, Tiranë.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.02.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-75738-02-10-2026, me objekt: Loti I “*Blerje mish viçi dhe mish pule*”, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 72,673,488 (*shtatëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë*) lekë pa TVSH ose 753,483.55 (*shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e pesë*) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 10.02.2026 është 96.45 lekë, zhvilluar më datë 24.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 24.03.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 26.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Kazazi Meat” ShPK	58,217,160	lekë	kualifikuar
3. “Argent Daci” P.F	72,655,883	lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik më datë 08.04.2026, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraparak.

II.5. Në datën 16.04.2026, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër elektronik A/2026/6550, dhe me nr. 1169/2026 prot, datë 17.04.2026, e operatorit ekonomik “*Argent Daci*” P.F. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Kazazi Meat*” SHPK, me argumentat si mëposhtë vijon:

Në këtë procedurë prokurimi kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik KAZAZI MEAT shpk, për mospërmbyllje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pika dh) për mospërmbyllje të pikës 2.3.7 kriterë të vecantë të kualifikimit, për oferte anomalisht të ulët, si dhe mosplotësim i dokumentacionit ligjor mbi dorezimin sipas afateve ligjore të dokumentacionin fizik për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentet mbi të cilat e mbështesim kërkesën tonë po i parashtrojmë në vijim:

Nga analiza e dokumentacionit të procedurës, rrethanave faktike dhe informacionit të disponueshëm publik, rezulton se ky kualifikim ka një sërë problematikash serioze, të cilat vënë në dyshim përputhshmërinë e operatorit ekonomik me kriteret ligjore dhe, në tërësi, cenojnë integritetin dhe ligjshmërinë e procedurës së prokurimit.

Në mënyrë të përmbledhur, këto problematika lidhen,

Së pari, me ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme dhe të verifikueshme se operatori ekonomik nuk ka qenë në gjendje të rregullt fiskale në momentin e dorëzimit të ofertës, në kundërshtim me kriteret detyruese të kualifikimit.

Së dyti, ka të dhëna publike, mediatike që evidentojnë shkelje të rënda fiskale nga ky subjekt, të cilat kërkojnë domosdoshmërisht një verifikim të thelluar nga autoriteti kontraktor mbi besueshmërinë dhe integritetin e tij.

Së treti, në dritën e praktikave të mëparshme dhe mënyrës së operimit të këtij operatori në procedura të ngjashme, lindin dyshime të arsyeshme mbi përmbushjen reale të kriterëve të kapacitetit teknik, duke vënë në diskutim aftësinë efektive për realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Së katërti, oferta e paraqitur nga ky operator paraqet elementë të një çmimi anomalisht të ulët, çka aktivizon detyrimin ligjor të autoritetit kontraktor për verifikim të thelluar dhe, në mungesë të sigurtë të justifikimeve bindëse, për refuzimin e saj.

Këto çështje, si të analizuara veçmas ashtu edhe në tërësinë e tyre, vlerësojmë se e bëjnë të domosdoshëm ushtrimin e verifikimeve të plota dhe të thelluara nga ana e autoritetit kontraktor, jo vetëm në nivel formal të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, por mbi të gjitha në nivel substancial të besueshmërisë së tij reale në treg dhe në raport me detyrimet ligjore.

Në këto kushte, vlerësojmë se autoriteti kontraktor nuk mund të kufizohet në një verifikim formal të vetëdeklarimeve të operatorit ekonomik, por ka detyrimin ligjor dhe logjik të kërkojë informacion të drejtpërdrejtë dhe zyrtar pranë organeve tatimore, lidhur me gjendjen reale të operatorit dhe çdo indicie për shkelje të rënda fiskale apo sjellje të përsëritur në kundërshtim me ligjin.

Ky detyrim merr edhe më shumë peshë në një situatë ku ekzistojnë indikatorë të tjerë të fortë dyshimi, përfshirë çmimin e ofertës, i cili paraqitet anomalisht i ulët dhe jo i justifikuar në raport me kushtet e tregut.

Natyrshëm, çdo informacion apo e dhënë e ardhur nga institucione të treta, përfshirë në rastin konkret strukturat e hetimit tatimor, nuk ka si të ketë efekt detyrues për autoritetin kontraktor në kuptimin e zëvendësimit të vlerësimit të tij mirëpo autoriteti kontraktor këto informacione, që mund dhe duhet t'i kërkojë dhe t'i marrë (duke mos i injoruar dhe publikimet mediatike), ti vlerësojë në harmoni me të gjitha provat dhe të dhënat e tjera të administruara në procedurë.

Vetëm përmes një vlerësimi të tillë tërësor dhe substancial mund të arrihet në një konkluzion të arsyetuar dhe bindës mbi besueshmërinë reale të operatorit ekonomik në fjalë.

Në mënyrë të veçantë, këto rrethana marrin një rëndësi të shtuar në rastin konkret, pasi objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me furnizimin me produkte ushqimore për kategori të ndjeshme konsumatorësh, siç janë fëmijët në çerdhe dhe kopshte. Në këtë kontekst, çdo dyshim mbi formalizimin e aktivitetit dhe gjurmueshmërinë e produkteve përkthehet drejtpërdrejt në risk për sigurinë ushqimore.

Në vijim, paraqiten në mënyrë të detajuar secila prej këtyre problematikave, së bashku me bazën ligjore dhe arsyetimin përkatës.

A. Kazazi-Meat shpk nuk ploteson Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit konkretisht pika dh).

Në procedurën e prokurimit Loti I Blerje mish viçi dhe mish pule , ekzistojnë dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik KAZAZI MEAT sh.p.k, dhe subjekti i tij mbeshtetet Chicken Farm Albania shpk, nuk kane paguar detyrimet fiskale dhe konkretisht në momentin e dorëzimit të ofertave më datë 24.03.2026, kanë qenë në status debitor ndaj organeve tatimore, me detyrime të pashlyera.

Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm përmes një vërtetimi zyrtar që mund të kërkohej pranë organeve tatimore kompetente, lidhur me gjendjen e detyrimeve për keto dy subjekte në datën përkatëse.

1. a. Në kriteret e përgjithshme të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) përcaktohet se: Sipas Formularit të Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit (Shtojca 8 e DST), operatori ekonomik deklaron se: në pikën dh) nuk ka detyrime të pashlyera për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një nga rastet përjashtimore të parashikuara në nenin 76/2 të ligjit për prokurimin publik.

Sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9 e DST), në Pjesën II Shkaqet e përjashtimit , seksioni A Deklarata për përmbushjen e kriteve të përgjithshme të kualifikimit , operatori ekonomik deklaron se: ka përmbushur të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Ky kriter, i parashikuar në DST, buron nga VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , konkretisht:

Neni 25 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes , pika 2, sipas së cilës operatori ekonomik duhet të plotësojë kriteret e nenit 76 dhe 77 të LPP-së për tu kualifikuar;

Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit , pika 2, germa dh) , ku përcaktohet detyrimi për deklarimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Ky rregull, i detajuar në VKM nr. 285/2021, buron nga neni 76 i ligjit për prokurimin publik Kriteret detyruese për skualifikim, i cili parashikon në pika 2 përcakton se:

operatori ekonomik skualifikohet kur ka shkelur detyrimet për pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore;

përfundimisht, nuk zbatohet skualifikimi kur çështja gjyqësore në lidhje me detyrimet tatimore është ende në proces dhe nuk ka një vendim të formës së prerë; nëse detyrimet janë tashmë të shlyera ose nëse, përpara shpalljes së procedurës së prokurimit, është lidhur një marrëveshje detyruese për shlyerjen e tyre; kur detyrimet kanë një vlerë të papërfillshme, deri në 10,000 lekë, ose kur operatori është njoftuar për detyrimin në një kohë të tillë që nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për ta shlyer para afatit të dorëzimit të ofertës.

Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) është i qartë, i plotë dhe pa ekuivok: operatori ekonomik duhet të mos ketë detyrime të papaguara për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, ose të ndodhet në një nga rastet përjashtimore të parashikuara në nenin 76, pika 2 të ligjit për prokurimin publik.

Nga sa rezulton, operatori ekonomik KAZAZI MEAT sh.p.k. dhe subjekti mbështetes Chicken Farm Albania shpk, në datën e dorëzimit të ofertave, konkretisht më 24.03.2026, kanë qenë subjekt me detyrime tatimore të pashlyera pranë organeve tatimore.

Në këto kushte, referuar natyrës strikte të këtij kriteri, rezulton se nëse provohet ekzistenca e detyrimeve në këtë datë, atëherë operatori ekonomik:

nuk ka përmbushur një kriter të përgjithshëm të kualifikimit; dhe ka paraqitur një vetëdeklarim të pasaktë, duke deklaruar se nuk ka detyrime tatimore të pashlyera, në kundërshtim me gjendjen faktike.

Për rrjedhojë, në referencë të nenit 76, pika 2 të LPP-së, operatori duhet të ishte skualifikuar nga procedura e prokurimit, pasi ka qenë në shkelje të detyrimeve në lidhje me pagesën e taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Kjo situatë nuk përbën thjesht një mospërmbushje kriteri, por edhe një rast tipik të paraqitjes së të dhënave të rreme për qëllime kualifikimi.

Në këtë kuptim, bëhet i aplikueshëm edhe neni 76, pika 5 e LPP-së, si dhe neni 78, pika 1, germa a, sipas të cilit Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet, në rast të keqinformimit dhe dorëzimit të dokumenteve që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i këtij kriteri nuk është thjesht formal apo presion mbi operatorët ekonomikë për të shlyer detyrimet e tyre, por garantimi që në procedurat e prokurimit publik të marrin pjesë vetëm operatorë ekonomikë që nuk janë në shkelje sa lidhet me detyrimet për pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, pasi vetë neni 76 i LPP-së parashikon se në procedurë mund të marrin pjesë edhe operatorë që kanë detyrime tatimore, për sa kohë këto janë të rregulluara përmes një marrëveshjeje detyruese

me organet tatimore; çka do të thotë se ekzistenca e detyrimeve në vetvete nuk e bën automatikisht operatorin të parregullt , nëse ai është në një situatë të ligjshme dhe të administruar pasi për arsye objektive OE mund të jetë në pamundësi paguese por ka marrë masa për përmbushjen e tyre në përputhje me rregullat.

Pra vetë formulimi i nenit 76, pika 2 (ka shkelur detyrimet) tregon qartë se ligjvënësi synon të përjashtojë nga konkurrimi çdo subjekt që, në momentin e pjesëmarrjes, nuk është në gjendje të rregullt fiskale.

Në këtë kontekst, çdo pagesë e mëvonshme e detyrimeve nga ana e operatorit ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. , apo i subjektit mbështetes Chicken Farm Albania shpk e kryer pas datës së dorëzimit të ofertës apo edhe gjatë fazave të mëvonshme të procedurës, nuk ka efekt shërues mbi shkeljen e kryer. Kjo pasi:

vlerësimi i përmbushjes së kriterëve bëhet në momentin e dorëzimit të ofertës; gjendja e mëvonshme nuk mund të ketë efekt prapaveprues për të legjitimuar një situatë që në momentin relevant ka qenë në kundërshtim me ligjin; pranimi i një logjike të tillë do të cenonte parimin e barazisë në trajtim dhe do të krijonte një avantazh të padrejtë për operatorë që nuk janë në përputhje me detyrimet ligjore në momentin e konkurrimit.

Përveç detyrimit për skualifikim në referencë të nenit 76, pika 2 dhe pika 5 të LPP-së, rezulton e domosdoshme që autoriteti kontraktor të procedojë edhe me raportimin pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

Në rastin konkret, operatori ekonomik ka paraqitur me vetëdije të dhëna të pasakta në ofertën e tij, duke deklaruar se nuk ka detyrime tatimore të pashlyera, ndërkohë që ka qenë plotësisht në dijeni se nëse do deklaronte të vërtetën (që ka detyrime të pashlyera) atëherë një gjendje e tillë përbën shkak të drejtpërdrejtë skualifikimi.

Për rrjedhojë, ky veprim përbën një keqinformim të qëllimshëm, të orientuar qartazi për të siguruar kualifikimin në procedurë.

Në këtë kuptim, bëhet plotësisht i aplikueshëm neni 78, pika 1, germa a e LPP-së, sipas të cilit Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet, në rast të keqinformimit dhe dorëzimit të dokumenteve që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

Procesi i prokurimit publik është konceptuar si një garë reale përpara autoriteteve të prokurimit publik, ndërmjet operatorëve ekonomikë, mbi bazën e meritës, integritetit dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore, kush ka ofertën me raportin më të mirë cilësi çmim.

Kur një operator paraqet të dhëna të rreme për të kaluar fazën e kualifikimit, ky proces deformohet në thelb, duke u zhvendosur nga një garë vlerash në një përpjekje për t ia hedhur autoriteteve të prokurimit publik, përmes deklarimeve të pasakta, me qëllim kalimin e filtrave

të kualifikimit dhe sigurimin e një avantazhi të padrejtë situatë kjo që është në thelb e papranueshme dhe cenon integritetin e procedurës.

Një praktikë e tillë është e patolerueshme ndaj dhe ligjvënësi ka parashikuar masa përjashtuese të qarta dhe proporcionale në nenin 78, për të ndëshkuar dhe parandaluar sjellje të tilla.

Në vazhdim të sa më sipër kundërshtojmë kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Kazazi Meat shpk me arsyen se: Operatori ekonomik Kazazi Meat shpk si dhe subjektit mbështetës Chicken Farm Albania shpk kanë paraqitur dokumentet provuese të Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit (statusin aktiv, vërtetimet për pagesën e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore etj) me data pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave, duke ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës në kundërshtim me nenin 26 të VKM nr. 285/2020 dhe nenin 91 të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, të cilët ndalojnë çdo dorëzim apo modifikim dokumentacioni pas afatit.

Referuar subjektit mbështetës Chicken Farm Albania shpk, i cili nuk operon në fushën e prokurimeve publike, shoqëria jonë kundërshton ofertën ekonomike të kualifikuar të parin Kazazi Meat shpk pasi subjekti ku ky operator mbështetet nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit pasi datat e provueshmerise se dokumentacionit ligjor për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit i perkasin datave pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave.

Akoma me tej, vet operatori ekonomik Kazazi Meat shpk, referuar edhe kundërshtimit tonë mbi mosplotësimin e detyrimeve tatimore kemi bindjen e arsyetuar se ky operator nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor me data para përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave.

Në Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatorët Kazazi Meat shpk dhe subjekti mbështetës Chicken Farm Albania shpk, kanë deklaruar se i plotësojnë të gjitha kriteret ligjore të pranimit, megjithëse dokumentet ligjor që vërtetojnë këtë janë lëshuar pas afatit të dorëzimit të ofertës. Ky fakt krijon dyshime të arsyeshme se në momentin e ofertimit operatori ekonomik dhe subjekti mbështetës mund të ketë qenë debitor aktiv ndaj tatimeve apo sigurimeve dhe vetëm pasi janë klasifikuar kanë rregulluar detyrimet, duke përfituar në kundërshtim me parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të parashikuara në nenin 3 të Ligjit për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, oferta e këtij operatori duhet të konsiderohet e pavlefshme.

Në shtojcën 9, të dokumenteve standartet të tenderit, kriteret e përzgjedhjes/ kualifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Pra, në dokumentacionin e dorëzuar pranë autoriteti kontraktor duhet të dorëzoheshin dokumentacioni i operatorit ekonomik Kazazi- Meat shpk dhe operatorit Chicken Farm Albania shpk, si subjektit mbështetës.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomik të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për tu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit Për pasojë, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nisur nga Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit operatori ekonomik Kazazi- Meat shpk duhet të ketë dorëzuar në autoritetin kontraktor, në bazë të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , i ndryshuar, dokumentacionin e deklaruar më sipër për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit jo vetëm të tij por edhe të subjektit mbështetës Chicken Farm Albania shpk, të cilat shërbejnë si provë për vërtetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, me qëllim përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor.

Referuar sa më sipër, kërkojmë të verifikohen dokumentacioni fizik i dorëzuar në përmbushje të deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit të operatori ekonomik Kazazi- Meat shpk si dhe të subjektit mbështetës Chicken Farm Albania shpk, pasi ato nuk janë të vlefshme në ditën e hapjes së ofertave, referuar datës së zhvillimit të kësaj procedure.

Pra, shoqëria jonë pretendon se dokumentacioni i dorëzuar me qëllim përmbushjen e kriterit të përgjithshëm të kualifikimit, të dorëzuara nga operatori ekonomik dhe nga subjekti mbështetës, nuk janë të vlefshëm në ditën e hapjes së ofertave, e cila referuar SPE rezulton më datë 24.03.2026, pasi ato figurojnë të lëshuara pas kësaj date.

Pra, për dokumentacionin si: QKB, statusi aktiv, vërtetimet gjyqësore, tatimore, Ekstrakt të regjistrimit të pronarëve përfitues të thjeshtë dhe historik, etj në përmbushje të deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit nga operatori ekonomik Kazazi- Meat shpk dhe subjekti mbështetës Chicken Farm Albania Shpk, nuk janë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi figurojnë të datës pas hapjes së ofertave, duke mospërmbushur në këtë mënyrë edhe kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe si rrjedhim pretendimi jonë qëndron dhe oferta e operatorit ekonomik Kazazi- Meat shpk, duhet të skualifikohet.

Qëndrime të njëjtë ka mbajtur dhe Komisioni i Prokurimit PubliK në Vendimin Nr. 11/2026 datë 06.01.2026. (konkretisht faqa 8 deri në 17) (Bashkangjitur vendimin e KPP).

B. Kazazi-Meat shpk nuk plotëson kriterin pika 2.3.7 tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.

Sic është e njohur, referuar njoftimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE), publikohen vetëm të dhëna mbi kualifikimin ose skualifikimin e operatorëve ekonomikë, ndërsa, edhe pse palët e interesuara kanë të drejtë të parashtrojnë kontestime lidhur me rezultatet e procedurës, nuk vihet në dispozicion informacion i detajuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Në këtë kuadër, duke iu referuar edhe përvojave të mëparshme të këtij operatori në procedura të prokurimit publik, krijohen dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. nuk përmbush në mënyrë të plotë kriterin themelor për kapacitetet teknike.

1. Siç jemi njohur nga padia e këtij subjekti ndaj një vendimi skualifikimi nga AK dhe KPP në një procedurë tjetër prokurimi nr REF-20171-09-17-2024, Kazazi Meat demonstroi se është e pajisur me licencat:

Kodi II.1.A.1, LN-4949-04-2018 prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për aktivitetin specifik përpunim mishi;

Kodi II.1.B, LN-4948-04-2018 shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (mish);

Kodi II.1.A.1 LN-7526-02-2014 prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (thertore).

Por përgjatë procedurës së prokurimit operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. nuk kishte paraqitur licencën thelbësore që lidhet me përmbushjen e kriterit të kapaciteteve teknike, konkretisht licencën për prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz (thertore), e cila është element thelbësor i veprimtarisë objekt prokurimi.

Nisur nga kjo indicie natyrshëm që në rastin konkret të kësaj procedure prokurimi të shpallur nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë janë dy mundësi që ose e ka paraqitur ose nuk e ka paraqitur këtë licencë nr LN-7526-02-2014 për prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (thertore).

Referuar Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), kriteri 2.3.7 përcakton shprehimisht se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licencë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit, konkretisht:

Për operatorët ekonomikë vendas kërkohet licencë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), përfshirë kategorinë II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, dhe nënkategorinë II.1.A.1 Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Në vijim, analiza e këtij rasti kërkon domosdoshmërisht verifikimin e saktë të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në procedurën objekt ankimi, duke u bazuar në dy skenarë të mundshëm faktikë dhe juridikë.

Nëse Kazazi Meat si në rastet e mëparshme, për përmbushjen e kriterit teknik ka paraqitur licencën për përpunim mishi e jo atë për thertore atëherë kjo liçencë nuk përmbush kriterin 2.3.7 të DST.

Për të demonstruar përmbushjen e kriterit të përcaktuar në DST, nëse operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. , ashtu si në raste të mëparshme, ka paraqitur vetëm licencën Kodi II.1.A.1, LN-4949-04-2018 prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për veprimtarinë specifike përpunim mishi , rezulton se kjo liçencë nuk përmbush kërkesën e përcaktuar në kriterin 2.3.7 të DST-së.

Ky kriter parashikon shprehimisht se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë liçencë me emërtim përshkrues të veprimtarisë, në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit, pra që lidhet me prodhimin dhe/ose tregtimin e mishit sipas kërkesave të kontratës.

Në rastin konkret, licenca e paraqitur pasqyron qartazi se veprimtaria e autorizuar për operatorin është përpunim mishi , e cila nuk është ekuivalente me veprimtarinë e kërkuar në procedurën objekt ankimi, që lidhet me prodhimin dhe furnizimin me mish të freskët për konsum njerëzor.

Kjo rezulton edhe nga akti i miratimit të kërkesës për licencim, sipas shkresës nr. 2041/2 prot., datë 28.06.2021 të AKU-së, ku përcaktohet se licenca është dhënë për veprimtarinë përpunim mishi , bazuar në verifikimet në vend të inspektorëve kompetentë të AKU-së, të cilët kanë konfirmuar përmbushjen e kriterëve për këtë lloj aktiviteti.

Pra, përmes kësaj licence, operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. vërteton se është i licencuar për përpunimin e mishit (kryesisht të mishit të ngrirë dhe produkteve të tij), si dhe për tregtimin e produkteve të përpunuara, por jo për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit dhe furnizimit me mish të freskët sipas objektit të procedurës së prokurimit.

Në këtë drejtim, është e rëndësishme të dallohet qartë midis dy llojeve të stabilimenteve:

Stabilimenti i përpunimit të mishit:

Ka si funksion përpunimin e mishit të përftuar nga burime të tjera, si dhe prodhimin e produkteve të sallamerisë dhe produkteve të marinuara;

Proceset kryesore përfshijnë përgatitjen e brumit të produkteve, shtimin e erëzave, aditivëve dhe konservantëve, si dhe procese si tymosje, tharje, marinim dhe paketim;

Operon nën kërkesa të larta higjieno-sanitare për parandalimin e kontaminimit të produkteve të përpunuara.

Stabilimenti i prodhimit të mishit (thertore):

Ka si funksion therjen e kafshëve dhe prodhimin e mishit të freskët;

Proceset kryesore përfshijnë therjen, heqjen e organeve të brendshme, prerjen dhe përgatitjen për shpërndarje të menjëhershme;

Operon nën standarde shumë të rrepta higjieno-sanitare dhe kontroll të vazhdueshëm veterinar, për shkak të riskut të lartë të ndotjes bakteriale dhe afateve shumë të shkurtra të ruajtjes dhe tregtimit (deri në 7 ditë).

Nga ky dallim rezulton qartë se licenca e paraqitur nga operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. , që lidhet me përpunimin e mishit, nuk mund të konsiderohet si përmbushje e kriterit për kapacitet teknik për prodhimin dhe furnizimin me mish të freskët, siç kërkohet në mënyrë eksplicite nga DST.

Në të kundërt, kjo licencë dëshmon vetëm kapacitetin e operatorit për:

sigurimin e lëndës së parë (mish të ngrirë apo produkte shtazore) për përpunim; kryerjen e proceseve teknologjike të përpunimit (marinim, kriposje, aditivim, konservim); garantimin e kushteve për përpunim dhe paketim të produkteve të përpunuara;

por nuk provon kapacitetin për:

*prodhimin dhe furnizimin me mish të freskët;
ushtrimin e aktivitetit të therjes dhe tregtimit të mishit të freskët;
menaxhimin e zinxhirit të furnizimit nën regjim të rreptë kohor dhe temperaturash, siç kërkohet për mishin e freskët.*

Këto elemente janë objektivisht të dallueshme dhe të përcaktuara në aktet e licencimit, dhe nuk përbëjnë interpretime subjektive, por rrjedhojë të drejtpërdrejtë të përmbajtjes së licencës dhe procedurës së miratimit të saj.

Në këtë drejtim, në një qëndrim zyrtar të Agjencisë Kombëtare të Ushqimit (AKU), përcjellë me shkresën nr. 411/1 prot., datë 04.03.2022, është sqaruar se licenca e kategorisë II.1.A, me veprimtari prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz me nënkategori thertore, lidhet me aktivitetin e therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit të freskët. (Bashkangjitur Shkresa)

Per te vertetuar kete fakt subjekti yne i eshte drejtuar ne daten 24.02.2025 Autoritetit Kombetar te Ushqimit me shkresen Nr 1258 prot te tyren me kerkesen per interpretim lidhur me pyetjen:

A mundet qe nje subjekt qe eshte licencuar me licence te tipit II.IA.1 Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez me kufizime specifike te licences Prodhim, perpunim, ambalazhim, etiketim e shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez Perpunim Mishi, te ushtroje veprimtarine Prodhim dhe shperndarje me shumice e mishit te vicit fresket ?

Autoriteti Kombetar i Ushqimit me shkresen Nr 1701 prot date 18.03.2025 ka kthyer pergjigjen si me poshte:

Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez me kodin II.I.A.1 me aktivitetin specifik (perpunim mishi) nuk mundet te ushtroje veprimtarine ne aktivitetin Prodhim, dhe shperndarje me shumice te mishit te fresket (bashkangjitur shkresa e AKU).

Në këtë kuptim, çdo përpjekje për të barazuar licencën e përpunimit të mishit me licencimin për prodhim dhe furnizim me mish të freskët është objektivist e pabazuar dhe në kundërshtim me vetë përmbajtjen e akteve të licencimit.

Rrjedhimisht, pretendimi për përmbushjen e kriterit 2.3.7 mbi bazën e kësaj licence rezulton i pambështetur dhe çon në përfundimin se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e kapaciteteve teknike të kërkuara nga DST për këtë procedurë prokurimi.

Edhe nëse Kazazi Meat ka paraqitur licencën për thertore, ekziston domosdoshmëria e verifikimit substancial të kapacitetit teknik.

Nëse operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. ka paraqitur edhe licencën LN-7526-02-2014 prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (thertore) , atëherë, në mënyrë formale, do të konsiderohej se është plotësuar kriteri 2.3.7 i DST-së, pasi kjo licencë përmban emërtimin përshkrues të veprimtarisë në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit.

Mirëpo, një konstatim i tillë formal nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm dhe nuk përjashton detyrimin për verifikim të plotë dhe substancial të kapacitetit real teknik të operatorit ekonomik.

Sikurse është parashtruar edhe më sipër, nga praktikatat e mëparshme të pjesëmarrjes së këtij operatori në procedura të tjera prokurimi, me interes dhe vlerë ekonomike të konsiderueshme, rezulton se Kazazi Meat sh.p.k. nuk e ka paraqitur këtë licencë (LN-7526-02-2014), ndonëse e ka disponuar atë.

*Në këto kushte, lindin natyrshëm dy pyetje thelbësore:
përse kjo licencë nuk është paraqitur në procedurat e mëparshme të prokurimit publik;
dhe përse paraqitet në këtë procedurë konkrete.*

Nga këto rrethana krijohet një indicie e arsyeshme se dokumentacioni mbi kapacitetet teknike paraqitet në mënyrë jo konsistente, çka kërkon domosdoshmërisht verifikim të thelluar nga autoriteti kontraktor.

*Në mënyrë logjike, mosparaqitja e kësaj licence në procedura të mëparshme ngre dyshime të arsyeshme se mund të ekzistojnë një ose më shumë nga këto rrethana, ndër të tjera:
mungesë e titullit të ligjshëm të përdorimit të stabilimentit (pronësi ose kontratë noteriale qiraje/përdorimi);
mungesë e përmbushjes së kërkesave ligjore për funksionimin e thertores;*

ose ekzistenca e një stabilimenti që nuk është i legalizuar apo i pajisur plotësisht me lejet përkatëse.

Në procedurat e mëparshme të prokurimit, ky element ka qenë i përcaktuar shprehimisht si kriter kualifikimi, ku kërkohej që operatori ekonomik të disponojë minimalisht një stabiliment në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 Për ushqimin , i ndryshuar, dhe për këtë qëllim të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/përdorimi të vlefshme.

Edhe pse në procedurën objekt ankimi kjo kërkesë nuk është e detajuar në të njëjtën mënyrë, nga pikëpamja substanciale e kapacitetit teknik, Autoriteti Kontraktor nuk mund të kufizohet në verifikimin formal të ekzistencës së një licence, por ka detyrimin të vlerësojë nëse ekziston realisht dhe në mënyrë të ligjshme kapaciteti për ushtrimin e aktivitetit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Në këtë kuptim, fakti i disponimit formal të licencës nuk garanton në vetvete që operatori ekonomik do të ketë në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurt në dispozicion stabilimentin përkatës gjatë zbatimit të kontratës.

Rreziqet praktike që mund të materializohen gjatë ekzekutimit të kontratës janë reale dhe përfshijnë, ndër të tjera:

ndërprerjen e përdorimit të stabilimentit për shkak të mungesës së titullit ligjor mbi ambientin;

ndërhyrje nga autoritetet kompetente për shkak të ndërtimeve pa leje ose mospërmbljes së standardeve ligjore;

ose ndërprerje të aktivitetit për shkaqe të pavarura nga autoriteti kontraktor, duke krijuar pamundësi objektive për realizimin e kontratës.

Në këto kushte, kur vetë ekzistenca dhe disponueshmëria e stabilimentit nuk është e garantuar në mënyrë të ligjshme dhe të qëndrueshme (për shkak të mungesës së pronësisë, kontratës së vlefshme të përdorimit apo përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi), kontrata që mund të lidhet me këtë operator rezulton në thelb e pasigurt dhe e ekspozuar ndaj ndërprerjes, pra një kontratë në ajër.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor jo vetëm që nuk ka ndalesë, por ka detyrimin të verifikojë jo thjesht ekzistencën formale të licencës (si dokument), por ekzistencën reale dhe të ligjshme të kapacitetit teknik që ajo pretendon të mbulojë.

Në të kundërt, do të krijohet një situatë ku, për shkaqe të mundshme si humbja e posedimit të ambientit nga operatori, ndërhyrja e autoriteteve për prishje të ndërtimeve të paligjshme apo pezullimi i aktivitetit, kontrata do të bëhet e pazbatueshme, ndërkohë që operatori ekonomik do të mund të shmangte përgjegjësinë duke u mbështetur në rrethana të jashtme, duke

pretenduar se këto rreziqe nuk i atribuohen atij dhe nuk janë nën kontrollin e tij (nuk më pyetet lidhur me këtë risk).

Kjo situatë sjell në praktikë kalimin e riskut të ekzekutimit nga operatori ekonomik te Autoriteti Kontraktor, duke e bërë kontratën të pasigurt në zbatim.

Për rrjedhojë, edhe në rastin e paraqitjes formale të licencës LN-7526-02-2014, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të mos kufizohet në një vlerësim thjesht dokumentar, por të kryejë verifikim të plotë dhe substancial të ekzistencës dhe ligjshmërisë së stabilimentit, përmes korrespondencës me institucionet përkatëse, në funksion të garantimit të sigurisë së kontratës dhe shmangies së riskut në zbatim.

Në përfundim, nga analiza e mësipërme rezulton se, pavarësisht se cili nga dy skenarët qëndron në fakt, rezultati juridik mbetet i njëjtë.

Në rast se operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. nuk ka paraqitur licencën përkatëse për thertore, atëherë ai nuk përmbush kriterin e kapaciteteve teknike të përcaktuar në DST dhe duhet të skualifikohet.

Nga ana tjetër, edhe nëse kjo licencë është paraqitur në mënyrë formale, rrethanat e evidentuara lidhur me paraqitjen jo konsistente të saj në procedura të mëparshme dhe mungesa e garancisë mbi ekzistencën dhe disponueshmërinë reale të stabilimentit imponojnë detyrimin për verifikim të thelluar, në mungesë të të cilit kualifikimi i operatorit nuk mund të konsiderohet i ligjshëm.

Për rrjedhojë, në të dyja rastet, pranimi dhe kualifikimi i operatorit ekonomik në këtë procedurë bie ndesh me kërkesat e DST-së dhe parimet e prokurimit publik, duke e bërë të domosdoshëm skualifikimin e tij.

C. Mbi papërshtatshmërinë e operatorit ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. në kushtet informacioneve publike e mediatike për shkelje fiskale dhe detyrimin për verifikim nga autoriteti kontraktor.

Nga raportimet mediatike rezulton se gjatë një kontrolli tatimor në fund të 2025 në Kazazi Meat sh.p.k. janë konstatuar fshehje të ardhurash dhe diferenca të konsiderueshme tatimore, ku përmendet se janë evidentuar shitje mishi pa faturë në sasi të mëdha, me pasoja të rënda fiskale dhe të sigurisë ushqimore. <https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=cDtj5J45M-o> <https://zeri.ai/aktualitet-zbulohen-4-mije-ton-mish-te-dhe-mbi-9-mln-euro-te-padeklaruara-kallezim-penal-ndaj-subjektit-tregtar-ne-tiran-i237095> <https://ëëë.oraneës.tv/ekonomi/dokumentet-kazazi-miliona-euro-evazion-fiskal-lidhje-me-me-te-a-rrestuari-i1291089>.

Këto rrethana e tejkalojnë vlerësimin e thjeshtë formal nëse operatori ka apo jo detyrime të shlyera në momentin e ofertimit, duke përbërë të dhëna serioze jo thjesht mbi respektimin

real dhe të vazhdueshëm të detyrimeve ligjore por për shkeljen e rëndë të tyre, si një organizim i plotë.

Në këtë kuadër, situata e operatorit nuk paraqitet vetëm si një rast i mospagese të detyrimeve e deklarim të rremë lidhur me to, por edhe si një problematikë më e gjerë që lidhet me shkelje të rënda në fushën fiskale.

Në mënyrë të veçantë, këto shkelje kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në vetë sigurinë ushqimore.

Një produkt ushqimor i tregtuar në kushte evazioni fiskal nuk mund të garantojë gjurmueshmëri të zinxhirit të furnizimit, e cila përbën shtyllën kurrizore të sistemit të sigurisë ushqimore.

Mungesa e faturimit dhe formalizimit të transaksioneve cenon drejtpërdrejt identifikimin e origjinës së produktit, kontrollet sanitare dhe standardet e monitorimit, duke krijuar risk të shtuar për konsumatorin (aq më tepër që në rastin konkret janë fëmijë).

Për këtë arsye, këto rrethana nuk mund të neglizhohen nga strukturat e prokurimit publik, por kërkojnë domosdoshmërisht një verifikim të thelluar përmes korrespondencës me institucionet përgjegjëse.

Në mënyrë të qartë, neni 76, pika 2 e ligjit për prokurimin publik parashikon skualifikimin e operatorit ekonomik kur ai ka shkelur detyrimet në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, ndërsa rastet përjashtimore të parashikuara në të njëjtin nen nuk mund të shërbejnë si strehë për situata kur ekzistojnë të dhëna për shkelje të rënda, të qëllimshme dhe të përsëritura .

Në veçanti, kur ekzistojnë vendime administrative të formës së prerë që konfirmojnë detyrime të papaguara, ligji e trajton qartë subjektin si të papërshtatshëm për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik.

Kur të dhënat shkojnë përtej mosshlyerjes së detyrimeve dhe lidhen me praktika të klasifikuara nga organet kompetente si evazioni fiskal, autoriteti kontraktor nuk mund të kufizohet në një verifikim formal, por duhet të ushtrojë detyrimin për verifikim të plotë dhe të thelluar pranë institucioneve përgjegjëse.

Vetë ligji nr. 162/2020 Për prokurimin publik , në nenin 2 dhe nenin 3, vendos si objektiv dhe parim themelor jo vetëm efikasitetin dhe konkurrencën, por edhe garantimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Po kështu, neni 18 i këtij ligji ngarkon autoritetin kontraktor me detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e korrupsionit dhe për mbrojtjen e integritetit të procedurës.

Në këtë kuptim, është e papranueshme që procesi i vlerësimit të reduktohet në një verifikim mekanik dhe formal të ekzistencës ose jo të detyrimeve tatimore në një moment të caktuar, por duhet të shtrihet edhe në vlerësimin e sjelljes së përgjithshme të operatorit ekonomik në

raport me respektimin e legjislacionit në fuqi - ndërkohë që ekzistojnë të dhëna publike dhe indicie serioze për shkelje të rënda dhe të qëllimshme të legjislacionit fiskal nga operatori ekonomik.

Në këtë kuptim, pranimi i konceptit se

përjashtohet nga gara çdo operator që ka thjesht detyrime të pashlyera;

por nuk përjashtohet një operator për të cilin ka të dhëna publike e mediatike për kryerjen e evazionit fiskal nga një operator i caktuar, krijon një disproporcion të dukshëm logjik dhe juridik.

Situata mund të ilustruhet thjesht: nuk mund të mos pranosh në tavolinë një subjekt që ka një detyrim të zakonshëm financiar për shkak të pamundësisë së përkohshme të pagesës, ndërkohë që pranon një subjekt ndaj të cilit ka informacione për përfitim të paligjshëm dhe fshehje të qëllimshme të detyrimeve.

Një qasje e tillë është qartazi e papranueshme dhe bie ndesh me vetë logjikën e integritetit të procedurës së prokurimit publik. Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor nuk mund të mbështetet vetëm në vetëdeklarime apo verifikime formale, por ka detyrimin të kryejë verifikime të plota dhe substanciale pranë institucioneve përgjegjëse, në mënyrë që të sigurojë se operatori ekonomik që do të shpallet fitues është jo vetëm formalisht i rregullt, por edhe realisht i besueshëm dhe në përputhje me standardet ligjore.

D. Mbi skualifikimin për anomalisht të ulët të ofertës së OE Kazazi Meat sh.p.k. dhe detyrimin për refuzimin e saj.

Nga publikimi i vendimit të KVO rezulton se operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. ka ofertuar çmimin - 900 lekë/kg me TVSH për mish të freskët viçi.

Ndërkohë, referuar të dhënave zyrtare të INSTAT:

në shtator 2025 çmimi minimal i mishit të freskët të viçit ka qenë 1167 lekë/kg me TVSH;

në shkurt 2026 ka arritur në minimalisht 1201 lekë/kg me TVSH.

Pra, oferta e paraqitur është ndjeshëm më e ulët jo vetëm ndaj mesatares së tregut, por edhe ndaj çdo reference minimale reale, çka e bën atë qartazi dhe objektivisht anomalisht të ulët.

Ky konkluzion përforcohet edhe më tej nga konteksti ekonomik aktual, ku për shkak të zhvillimeve ndërkombëtare (luftërave botërore) dhe rritjes së kostove në zinxhirin e furnizimit tendenca e çmimeve është në rritje, jo në ulje.

Në këto kushte, një ofertë kaq e ulët nuk përbën thjesht një ofertë konkurruese , por një devijim të pajustificueshëm nga realiteti ekonomik i tregut.

Në këto kushte, aktivizohet drejtpërdrejt neni 93 i ligjit nr. 162/2020, i cili përcakton se:

kur oferta është anomalisht e ulët, autoriteti kontraktor ka detyrimin të kërkojë shpjegime (pika 1);

dhe më tej, duhet ta refuzojë ofertën nëse nuk bindet për rregullshmërinë e saj (pika 3). ndërkohë, sipas VKM nr. 285/2021, neni 82, KVO ka detyrimin:

të identifikojë ofertat anomalisht të ulëta sipas formulës përkatëse; dhe, në varësi të vlerës së procedurës, t i refuzojë ose të kërkojë shpjegime të detyrueshme.

Edhe në rastin kur aplikohet formula standarde, ajo nuk mund të përdoret si alibi për të anashkaluar një realitet të dukshëm:

kur një ofertë është në mënyrë flagrante jashtë çdo logjike tregu, anomalia është evidente aqik dhe kërkon trajtim substancial, jo formal.

Asnjë nga elementet e parashikuara në nenin 93, pika 2, nuk mund të justifikojë këtë nivel çmimi:

nuk rezulton ndonjë avantazh ekonomik i jashtëzakonshëm real;

nuk ka zgjidhje teknike apo metodologjike që ulin në këtë masë koston e mishit të freskët; nuk

ka asnjë indicie për origjinalitet apo inovacion në furnizim;

përkundrazi, një çmim i tillë ngre dyshime serioze për mosrespektim të detyrimeve ligjore, përfshirë ato fiskale dhe të sigurisë ushqimore.

Në këto kushte, mbetet logjikisht vetëm dy mundësi:

ose oferta mbështetet në praktika të paligjshme (p.sh. evazion fiskal, siç rezulton nga problematikat e evidentuara më sipër për këtë operator);

ose furnizimi nuk do të realizohet me mish viçi të freskët sipas specifikimeve, por me produkte të tjera gjoja te ngjashme si psh mish lope ne vend tee mishit tee vicit, në shkelje të kontratës.

Të dyja këto alternativa janë të papranueshme ligjërisht.

Edhe jashtë analizës strikte ligjore, situata është lehtësisht e kuptueshme:

askund në tregun shqiptar nuk mund të sigurohet mish viçi i freskët me 900 lek/kg me TVSH; me asnjë konsumator racional sado qe gjithnje eshte i interesuar peer cmimin me te ulet, nuk do të besonte një ofertë të tillë pa dyshime serioze mbi cilësinë dhe origjinën e produktit.

Kjo tregon se nuk kemi të bëjmë me një ofertë konkurruese, por me një ofertë që bie ndesh me vetë logjikën bazë të tregut.

Kjo çështje merr rëndësi edhe më të madhe në këtë procedurë, pasi bëhet fjalë për furnizim ushqimor për kategori të ndjeshme, konkretisht fëmijë të vegjël.

Në këtë kontekst çmimi anomalisht i ulët nuk është vetëm çështje ekonomike; por lidhet drejtpërdrejt me sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik.

Në këto kushte kur oferta e OE Kazazi Meat sh.p.k. është qartazi anomalisht e ulët dhe nuk ekziston asnjë bazë reale për justifikimin e saj sipas nenit 93 dhe se AK ka detyrimin ligjor për ta verifikuar atë ateeherë mMosrefuzimi i saj përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 93 të LPP dhe nenit 82 të VKM nr. 285/2021, duke cenuar parimet themelore të barazisë, konkurrencës së ndershme dhe sigurisë së kontratës publike.

Parashikohet si një kundërargument i mundshëm që çmimet e referuara nga INSTAT i përkasin tregut me pakicë (konsumatorit fundor), ndërsa operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. mund të pretendojë se operon me çmime shumice.

Ky argument nuk qëndron,:

Së pari, në kuadër të kësaj kontrate publike nuk kemi të bëjmë me një shitje tipike me shumicë në kuptimin ekonomik të termit, pra një furnizim të vetëm në sasi të mëdha me destinacion rishitjeje. Përkundrazi, nga vetë natyra e objektit të kontratës rezulton se: furnizimi realizohet në mënyrë periodike (ditore/javore), në sasi të fragmentuara dhe të shpërndara dhe drejtpërdrejt për konsum nga përfituesit fundorë (çerdhe/kopshte).

Së dyti, karakteristika thelbësore e produktit mish i freskët viçi e përjashton praktikisht mundësinë e një furnizimi të mirëfilltë me shumicë, për shkak të:

*afatit shumë të shkurtër të përdorimit (rreth 7 ditë);
kërkesës për zinxhir të pandërprerë të temperaturës;
nevojës për shpërndarje të menjëhershme dhe të kontrolluar.*

Kjo do të thotë se operatori nuk po kryen një shitje me shumicë në kuptimin klasik (një volum i madh i dorëzuar njëherësh), por një furnizim të vazhdueshëm, të fragmentuar dhe operacionalisht të krahasueshëm me shitjen për konsum final.

Së treti, edhe në planin ekonomik, diferenca ndërmjet çmimit të shumicës dhe atij të pakicës në produkte të tilla nuk mund të justifikojë një devijim kaq ekstrem, nga rreth 1200 lek/kg në 900 lek/kg.

Pra, edhe nëse merret në konsideratë një marzh i arsyeshëm tregtar, sërish:

*çmimi i ofertuar mbetet në mënyrë flagrante jashtë çdo logjike tregu;
dhe nuk mund të justifikohet me natyrën me shumicë të kontratës.*

Në këto kushte, pretendimi se çmimi i ulët justifikohet nga fakti se kemi të bëjmë me shitje me shumicë:

*është i pabazuar në fakt (pasi kontrata nuk realizohet si shitje klasike me shumicë);
dhe i pajustificuar ekonomikisht, pasi nuk shpjegon diferencën e theksuar me çmimet reale të tregut.*

Për rrjedhojë, ky argument nuk mund të përdoret për të rrëzuar konkluzionin se oferta e paraqitur është anomalisht e ulët në kuptim të nenit 93 të LPP.

Përfundimisht, për sa me sipër kërkojmë:

1. Kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Kazazi Meat shpk, për mospërmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pika dh) për mospërmbushje të pikës 2.3.7 kriteret e vecanta të kualifikimit, për oferte anomalisht të ulët, si dhe mospërmbushje të dokumentacionit ligjor mbi dorezimin sipas afateve ligjore të dokumentacionit fizik për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

II.6. Në datën 20.04.2026, nëpërmjet shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër 1169/1 prot, datë 20.04.2026, e operatorit ekonomik “*Argent Daci*” P.F. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Kazazi Meat*” SHPK, më përmbajtje si më sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1169/2 prot., datë 20.04.2026, duke publikuar kriteret e kualifikimit të cilat ankimuesi “*Argent Daci*” PF pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “*Kazazi Meat*” SHPK.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se më datë 21.04.2026 operatori ekonomik i interesuar “*Kazazi Meat*” SHPK ka paraqitur formularin e argumentave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “*Argent Daci*” PF protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 1169/3 prot, datë 21.04.2026, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

II.9. Me shkresën e datës 27.04.2026 06.01.2026, me objekt “*Ekstrakt i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*”, protokolluar me tonën me nr. 1169/4 prot., datë 27.04.2026, ardhur nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresës nr. 634/6 prot, datë 27.04.2026, me objekt “*Kthim përgjigje e operatorit ekonomik Argent Daci PF, në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar me objekt Loti I Blerje mish viçi dhe mish pule*” protokolluar me tonën me nr. 1169/5 prot., datë 29.04.2026, ardhur nëpërmjet shërbimit postar autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF, ku ka vendosur mospranimin e pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “*Argent Daci*” PF.

II.10. Me shkresën e datës 04.05.2026 me objekt “Kërkesë për konfirmim nëse vërtetimi fiskal i datës 15.12.2025 i OE “Kazazi Meat” SHPK është konsideruar që provon se nuk ka detyrime fiskale në mars 2026, apo bëhet fjalë për lapsus në vendimin e KSHA” protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 1169/6 prot, datë 06.05.2026 operatori ekonomik ankimues i është drejtuar autoritetit kontraktor, duke vënë në dijeni edhe Komisionin e Prokurimit Publik.

II.11. Me shkresën e datës 05.05.2026 me objekt “Shtesë argumentash lidhur me vendimin nr. 634/6 prot, datë 27.04.2026 nga DPCK Tiranë mbi procedurën e prokurimit REF-75738-02-10-2026 në proces ankimi” protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 1169/7 prot, datë 07.05.2026 operatori ekonomik ankimues ka depozituar argumenta shtesë kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 1169/8 prot., datë 18.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që në zbatim të nenit 114 të LPP të dërgojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari “Kazazi Meat” SHPK.

II.13. Me shkresën nr. 634/10 prot, datë 15.05.2026 me objekt “Kërkesë për përshpejtim të shqyrtimit të ankesës”, protokolluar me tonën me nr. 1169/9 prot, datë 19.05.2026 autoriteti kontraktor ka kërkuar përshpejtimin e shqyrtimit të ankesës.

II.14. Me shkresën nr. 634/12 prot, datë 22.05.2026, me objekt “Kthim përgjigje”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1169/10 prot., datë 22.05.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik dokumentacionin e dorëzuar pranë tij nga operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK.

II.15. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 1169/11 prot., datë 02.06.2026 me objekt “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë duke i kërkuar informacion si më poshtë vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, po shqyrton një ankesë lidhur me procedurat e prokurimit publik. Bazuar në nenin 115 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kërkojmë nga ana juaj të na informoni si vijon:

1- Në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi një subjekti biznes i madh (në kuptim të legjislacionit tatimor), kur i lind e drejta e deklarimit dhe afati i pagesës për – Tatimin mbi fitimin; - Tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (TAP); - Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore; -Tatimin në burim; - Tatimin mbi vlerën e shtuar; - Taksave kombëtare; - Tarifave kombëtare.

2- Operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK me NIPT K73609801E, nga data 16.12.2025 – 24.03.2026 ka patur detyrime të papaguar lidhur me Tatimin mbi fitimin; - Tatimin mbi të

ardhurat nga punësimi (TAP); - Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore; - Tatimin në burim; - Tatimin mbi vlerën e shtuar; - Taksave kombëtare; - Tarifave kombëtare ?

Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomik në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi dërgimin e informacionit tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

II.16. Me shkresën nr. 634/13 prot, datë 03.06.2026 me objekt “Kërkesë për përshpejtim të shqyrtimit të ankesës”, protokolluar me tonën me nr. 1169/12 prot, datë 05.06.2026 autoriteti kontraktor ka kërkuar përshpejtimin e shqyrtimit të ankesës.

II.17. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 1169/13 prot., datë 24.06.2026 me objekt “Rikërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë duke i kërkuar informacion si më poshtë vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, po shqyrton një ankesë lidhur me procedurat e prokurimit publik. Bazuar në nenin 115 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kërkojmë nga ana juaj të na informoni si vijon:

1- Në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi një subjekti biznes i madh (në kuptim të legjislacionit tatimor), kur i lind e drejta e deklarimit dhe afati i pagesës për – Tatimin mbi fitimin; - Tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (TAP); - Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore; -Tatimin në burim; - Tatimin mbi vlerën e shtuar; - Taksave kombëtare; - Tarifave kombëtare.

2- Operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK me NIPT K73609801E, nga data 16.12.2025 – 24.03.2026 ka patur detyrime të papaguar lidhur me Tatimin mbi fitimin; - Tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (TAP); - Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore; - Tatimin në burim; - Tatimin mbi vlerën e shtuar; - Taksave kombëtare; - Tarifave kombëtare ?

Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomik në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi dërgimin e informacionit tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

II.18. Me shkresën nr. 1169/14 prot., datë 24.06.2026, me objekt “Vënje në dijeni” Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të nenit 115 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 ka vënë në dijeni autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik pjesëmarrës, se për shkaqe të nevojshme për verifikim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brënda afateve të parashikuara nga ligji.

II.19. Me shkresën nr. 7829/1 prot, datë 03.07.2026, me objekt “Kthim përgjigje”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1169/15 prot., datë 07.07.2026

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik informacion si më poshtë vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj, nr. 1169/13 prot, datë 24.06.2026, përcjellë në DTM me shkresën e DRT Tiranë me Nr. 10524/2 prot, datë 29.06.2026, të protokolluar në DTM me Nr. 7829 prot, datë 30.06.2026 me lëndë “Rikërkesë për informacion për shoqërinë Kazazi Meat shpk, me NIPT K73609801E”, ju bëjmë me dije si vijon:

Afati i deklarimit dhe pagesës së tatimeve dhe kontributeve për personat juridik, përcaktohen sipas legjislacionit tatimor përkatës, si më poshtë:

- Referuar ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 107, “Deklarata e TVSH-së, duhet të dorëzohet jo më vonë se XX ditë pas përfundimit të periudhës tatimore që deklarohet”.

- Referuar ligjit nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 61, “Deklarata tatimore vjetore e tatimit mbi fitimin korporativ, dorëzohet në organin tatimorë jo më vonë se data XXXX e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.

- Referuar ligjit nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 63, pika 2 “Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan në llogarinë e organeve tatimore këstet tremujore të tatimit mbi fitimin Brenda datës XXXX për muajt janar, shkurt dhe mars; Brenda datës XXXX për muajt pill, maj dhe qershor; Brenda datës XXXX për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe Brenda datës XXXX për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor”.

- Referuar ligjit nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 56, “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim detyrohet të deklarojë dhe të paguajë tatimin e mbajtur në llogarinë e të ardhurave të organeve tatimore deri në datën XXX të muajit që pason muajin e pagesës osë mbajtjes së tatimit”.

- Referuar ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, “Deklarimi dhe pagesa e kontributeve nga personat juridikë bëhet brenda datës XXXXX të muajit pasardhës”. Afati i deklarimit është dhe afati i pagesës për secilin tatim/kontribut.

Duke qenë se sistemi tatimor nuk ruan historik të detyrimeve për një datë të caktuar, bashkëlidhur po ju përcjellim situatën e detyrimeve në kohë reale të datës 02.07.2026 të shoqërisë Kazazi Meat shpk me NIPT K73609801E. Referuar këtyre detyrimeve në shumën XXXX lekë, vetëm vlera prej XXXXX (që i përketë parapagimit të tatimit mbi të ardhurat e korporatës Korrik 2026) është brenda afatit për pagesë. Shoqëria Kazazi Meat shpk me NIPT K73609801E nuk është e rregjistruar për përgjegjësitë tatimore Taksa Kombëare dhe Tarifa Kombëtare.

II.20. Me shkresën nr. 634/15 prot, datë 27.07.2026 me objekt “Kërkesë”, protokolluar me tonën me nr. 1169/16 prot, datë 29.07.2026 autoriteti kontraktor ka kërkuar përshejtimin e shqyrtimit të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK, me argumentin se: “A. Kazazi-Meat shpk nuk ploteson Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit konkretisht pika dh). Në procedurën e prokurimit Loti I Blerje mish viçi dhe mish pule , ekzistojnë dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik KAZAZI MEAT sh.p.k, dhe subjekti i tij mbështetes Chicken Farm Albania shpk, nuk kane paguar detyrimet fiskale dhe konkretisht në momentin e dorëzimit të ofertave më datë 24.03.2026, kanë qenë në status debitor ndaj organeve tatimore, me detyrime të pashlyera. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm përmes një vërtetimi zyrtar që mund të kërkohe pranë organeve tatimore kompetente, lidhur me gjendjen e detyrimeve për keto dy subjekte në datën përkatëse. 1. a. Në kriteret e përgjithshme të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) përcaktohet se: Sipas Formularit të Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit (Shtojca 8 e DST), operatori ekonomik deklaron se: në pikën dh) nuk ka detyrime të pashlyera për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një nga rastet përjashtimore të parashikuara në nenin 76/2 të ligjit për prokurimin publik. Sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9 e DST), në Pjesën II Shkaqet e përjashtimit , seksioni A Deklarata për përmbushjen e kriteve të përgjithshme të kualifikimit , operatori ekonomik deklaron se: ka përmbushur të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Ky kriter, i parashikuar në DST, buron nga VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , konkretisht: Neni 25 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes , pika 2, sipas së cilës operatori ekonomik duhet të plotësojë kriteret e nenit 76 dhe 77 të LPP-së për tu kualifikuar; Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit , pika 2, germa dh) , ku përcaktohet detyrimi për deklarimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore. Ky rregull, i detajuar në VKM nr. 285/2021, buron nga neni 76 i ligjit për prokurimin publik Kriteret detyruese për skualifikim, i cili parashikon në pika 2 përcakton se: a) operatori ekonomik skualifikohet kur ka shkelur detyrimet për pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore; përjashtimisht, nuk zbatohet skualifikimi kur çështja gjyqësore në lidhje me detyrimet tatimore është ende në proces dhe nuk ka një vendim të formës së prerë; nëse detyrimet janë tashmë të shlyera ose nëse, përpara shpalljes së procedurës së prokurimit, është lidhur një marrëveshje detyruese për shlyerjen e tyre; kur detyrimet kanë një vlerë të papërfillshme, deri në 10,000 lekë, ose kur operatori është njoftuar për detyrimin në një kohë të tillë që nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për ta shlyer para afatit të dorëzimit të ofertës. Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) është i qartë, i plotë dhe pa ekuivok: operatori ekonomik duhet të mos ketë detyrime të papaguara për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, ose të ndodhet në një nga rastet përjashtimore të parashikuara në nenin 76, pika 2 të ligjit për prokurimin publik. Nga sa rezultojnë, operatori ekonomik KAZAZI MEAT sh.p.k. dhe subjekti mbështetes Chicken Farm Albania shpk, në datën e dorëzimit të

ofertave, konkretisht më 24.03.2026, kane qenë subjekt me detyrime tatimore të pashlyera pranë organeve tatimore. Në këto kushte, referuar natyrës strikte të këtij kriteri, rezulton se nëse provohet ekzistenca e detyrimeve në këtë datë, atëherë operatori ekonomik: nuk ka përmbushur një kriter të përgjithshëm të kualifikimit; dhe ka paraqitur një vetëdeklarim të pasaktë, duke deklaruar se nuk ka detyrime tatimore të pashlyera, në kundërshtim me gjendjen faktike. Për rrjedhojë, në referencë të nenit 76, pika 2 të LPP-së, operatori duhet të ishte skualifikuar nga procedura e prokurimit, pasi ka qenë në shkelje të detyrimeve në lidhje me pagesën e taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore. Kjo situatë nuk përbën thjesht një mospërmbushje kriteri, por edhe një rast tipik të paraqitjes së të dhënave të rreme për qëllime kualifikimi. Në këtë kuptim, bëhet i aplikueshëm edhe neni 76, pika 5 e LPP-së, si dhe neni 78, pika 1, germa a, sipas të cilit Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet, në rast të keqinformimit dhe dorëzimit të dokumenteve që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi. Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i këtij kriteri nuk është thjesht formal apo presion mbi operatorët ekonomikë për të shlyer detyrimet e tyre, por garantimi që në procedurat e prokurimit publik të marrin pjesë vetëm operatorë ekonomikë që nuk janë në shkelje sa lidhet me detyrimet për pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, pasi vetë neni 76 i LPP-së parashikon se në procedurë mund të marrin pjesë edhe operatorë që kanë detyrime tatimore, për sa kohë këto janë të rregulluara përmes një marrëveshjeje detyruese me organet tatimore; çka do të thotë se ekzistenca e detyrimeve në vetvete nuk e bën automatikisht operatorin të parregullt, nëse ai është në një situatë të ligjshme dhe të administruar pasi për arsye objektive OE mund të jetë në pamundësi paguese por ka marrë masa për përmbushjen e tyre në përputhje me rregullat. Pra vetë formulimi i nenit 76, pika 2 (ka shkelur detyrimet) tregon qartë se ligjvënësi synon të përjashtojë nga konkurrimi çdo subjekt që, në momentin e pjesëmarrjes, nuk është në gjendje të rregullt fiskale. Në këtë kontekst, çdo pagesë e mëvonshme e detyrimeve nga ana e operatorit ekonomik Kazazi Meat sh.p.k., apo i subjektit mbeshtetes Chicken Farm Albania shpk e kryer pas datës së dorëzimit të ofertës apo edhe gjatë fazave të mëvonshme të procedurës, nuk ka efekt shërues mbi shkeljen e kryer. Kjo pasi: vlerësimi i përmbushjes së kriterëve bëhet në momentin e dorëzimit të ofertës; gjendja e mëvonshme nuk mund të ketë efekt prapaveprues për të legjitimuar një situatë që në momentin relevant ka qenë në kundërshtim me ligjin; pranimi i një logjike të tillë do të cenonte parimin e barazisë në trajtim dhe do të krijonte një avantazh të padrejtë për operatorë që nuk janë në përputhje me detyrimet ligjore në momentin e konkurrimit. Përveç detyrimit për skualifikim në referencë të nenit 76, pika 2 dhe pika 5 të LPP-së, rezulton e domosdoshme që autoriteti kontraktor të procedojë edhe me raportimin pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji. Në rastin konkret, operatori ekonomik ka paraqitur me vetëdije të dhëna të pasakta në ofertën e tij, duke deklaruar se nuk ka detyrime tatimore të pashlyera, ndërkohë që ka qenë plotësisht në dijeni se nëse do deklaronte të vërtetën (që ka detyrime të pashlyera) atëherë një gjendje e tillë përbën shkak të drejtpërdrejtë skualifikimi. Për rrjedhojë, ky veprim përbën një keqinformim të qëllimshëm, të orientuar qartazi për të siguruar kualifikimin në procedurë. Në këtë kuptim, bëhet plotësisht i aplikueshëm neni 78, pika 1, germa a e LPP-së, sipas të cilit Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3

vjet, në rast të keqinformimit dhe dorëzimit të dokumenteve që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi. Procesi i prokurimit publik është konceptuar si një garë reale përpara autoriteteve të prokurimit publik, ndërmjet operatorëve ekonomikë, mbi bazën e meritës, integritetit dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore, kush ka ofertën me raportin më të mirë cilësi çmim. Kur një operator paraqet të dhëna të rreme për të kaluar fazën e kualifikimit, ky proces deformohet në thelb, duke u zhvendosur nga një garë vlerash në një përpjekje për t'ia hedhur autoriteteve të prokurimit publik, përmes deklarimeve të pasakta, me qëllim kalimin e filtrave të kualifikimit dhe sigurimin e një avantazhi të padrejtë situatë kjo që është në thelb e papranueshme dhe cenon integritetin e procedurës. Një praktikë e tillë është e patolerueshme ndaj dhe ligjvënësi ka parashikuar masa përjashtuese të qarta dhe proporcionale në nenin 78, për të ndëshkuar dhe parandaluar sjellje të tilla. Në vazhdim të sa me sipër kundërshtojmë kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Kazazi Meat shpk me arsyen se: Operatori ekonomik Kazazi Meat shpk si dhe subjektit mbështetës Chicken Farm Albania shpk kanë paraqitur dokumentet provuese të Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit (statusin aktiv, vërtetimet për pagesën e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore etj) me data pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave, duke ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës në kundërshtim me nenin 26 të VKM nr. 285/2020 dhe nenin 91 të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, të cilët ndalojnë çdo dorëzim apo modifikim dokumentacioni pas afatit. Referuar subjektit mbështetës Chicken Farm Albania shpk, i cili nuk operon në fushën e prokurimeve publike, shoqëria jonë kundërshton ofertën ekonomike të kualifikuar të parin Kazazi Meat shpk pasi subjekti ku ky operator mbështetet nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit pasi datat e provueshmerisë së dokumentacionit ligjor për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit i perkasin datave pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave. Akoma më tej, vet operatori ekonomik Kazazi Meat shpk, referuar edhe kundërshtimit tonë mbi mosplotësimin e detyrimeve tatimore kemi bindjen e arsyetuar se ky operator nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor me data para përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave. Në Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatorët Kazazi Meat shpk dhe subjekti mbështetës Chicken Farm Albania shpk, kanë deklaruar se i plotësojnë të gjitha kriteret ligjore të pranimit, megjithëse dokumentet ligjor që vërtetojnë këtë janë lëshuar pas afatit të dorëzimit të ofertës. Ky fakt krijon dyshime të arsyeshme se në momentin e ofertimit operatori ekonomik dhe subjekti mbështetës mund të ketë qenë debitor aktiv ndaj tatimeve apo sigurimeve dhe vetëm pasi janë klasifikuar kanë rregulluar detyrimet, duke përfituar në kundërshtim me parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të parashikuara në nenin 3 të Ligjit për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, oferta e këtij operatori duhet të konsiderohet e pavlefshme. Në shtojcën 9, të dokumenteve standartet të tenderit, kriteret e përzgjedhjes/ kualifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: Pra, në dokumentacionin e dorëzuar pranë autoriteti kontraktor duhet të dorëzoheshin dokumentacioni i operatorit ekonomik Kazazi- Meat shpk dhe operatorit Chicken Farm Albania shpk, si subjektit mbështetës. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet siguri i ofertimit nga operatorë ekonomik të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për tu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë

pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin ekontrates dhe në dokumentet e tenderit Për pasojë, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nisur nga Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit operatori ekonomik Kazazi- Meat shpk duhet të ketë dorëzuar në autoritetin kontraktor, në bazë të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , i ndryshuar, dokumentacionin e deklaruar më sipër për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit jo vetëm të tij por edhe të subjektit mbështetës Chicken Farm Albania shpk, të cilat shërbejnë si provë për vërtetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, me qëllim përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor. Referuar sa më sipër, kërkojmë të verifikohen dokumentacioni fizik i dorëzuar në përmbushje të deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit të operatori ekonomik Kazazi- Meat shpk si dhe të subjektit mbështetës Chicken Farm Albania shpk, pasi ato nuk janë të vlefshme në ditën e hapjes së ofertave, referuar datës së zhvillimit të kësaj procedure. Pra, shoqëria jonë pretendon se dokumentacioni i dorëzuar me qëllim përmbushjen e kriterit të përgjithshëm të kualifikimit, të dorëzuara nga operatori ekonomik dhe nga subjekti mbështetës, nuk janë të vlefshëm në ditën e hapjes së ofertave, e cila referuar SPE rezulton më datë 24.03.2026, pasi ato figurojnë të lëshuara pas kësaj date. Pra, për dokumentacionin si: QKB, statusi aktiv, vërtetimet gjyqësore, tatimore, Ekstrakt të regjistrimit të pronarëve përfitues të thjeshtë dhe historik, etj në përmbushje të deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit nga operatori ekonomik Kazazi- Meat shpk dhe subjekti mbështetës Chicken Farm Albania Shpk, nuk janë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi figurojnë të datës pas hapjes së ofertave, duke mospërmbushur në këtë mënyrë edhe kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe si rrjedhim pretendimi jonë qëndron dhe oferta e operatorit ekonomik Kazazi- Meat shpk, duhet të skualifikohet. Qëndrime të njëjtë ka mbajtur dhe Komisioni i Prokurimit PubliK në Vendimin Nr. 11/2026 datë 06.01.2026. (konkretisht faqa 8 deri ne 17) (Bashkangjitur vendimin e KPP). C. Mbi papërshtatshmërinë e operatorit ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. në kushtet informacioneve publike e mediatike për shkelje fiskale dhe detyrimin për verifikim nga autoriteti kontraktor. Nga raportimet mediatike rezulton se gjatë një kontrolli tatimor në fund të 2025 në Kazazi Meat sh.p.k. janë konstatuar fshehje të ardhurash dhe diferenca të konsiderueshme tatimore, ku përmendet se janë evidentuar shitje mishi pa faturë në sasi të mëdha, me pasoja të rënda fiskale dhe të sigurisë ushqimore. <https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=cDtj5J45M-o> <https://zeri.ai/aktualitet-zbulohen-4-mije-ton-mish-te-dhe-mbi-9-mln-euro-te-padeklaruara-kallezim-penal-ndaj-subjektit-tregtar-ne-tiran-i237095> <https://ëëë.oraneës.tv/ekonomi/dokumentet-kazazi-miliona-euro-evazion-fiskal-lidhje-me-me-te-a-rrestuari-i1291089>. Këto rrethana e tejkalojnë vlerësimin e thjeshtë formal nëse operatori ka apo jo detyrime të shlyera në momentin e ofertimit, duke përbërë të dhëna serioze jo thjesht mbi respektimin real dhe të vazhdueshëm të detyrimeve ligjore por për shkeljen e rëndë të tyre, si një organizim i plotë. Në këtë kuadër, situata e operatorit nuk

paraqitet vetëm si një rast i mospagese të detyrimeve e deklarim të rremë lidhur me to, por edhe si një problematikë më e gjerë që lidhet me shkelje të rënda në fushën fiskale. Në mënyrë të veçantë, këto shkelje kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në vetë sigurinë ushqimore. Një produkt ushqimor i tregtuar në kushte evazioni fiskal nuk mund të garantojë gjurmueshmëri të zinxhirit të furnizimit, e cila përbën shtyllën kurrizore të sistemit të sigurisë ushqimore. Mungesa e faturimit dhe formalizimit të transaksioneve cenon drejtpërdrejt identifikimin e origjinës së produktit, kontrollet sanitare dhe standardet e monitorimit, duke krijuar risk të shtuar për konsumatorin (aq më tepër që në rastin konkret janë fëmijë).

Për këtë arsye, këto rrethana nuk mund të neglizhohen nga strukturat e prokurimit publik, por kërkojnë domosdoshmërisht një verifikim të thelluar përmes korrespondencës me institucionet përgjegjëse. Në mënyrë të qartë, neni 76, pika 2 e ligjit për prokurimin publik parashikon skualifikimin e operatorit ekonomik kur ai ka shkelur detyrimet në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, ndërsa rastet përjashtimore të parashikuara në të njëjtin nen nuk mund të shërbejnë si strehë për situata kur ekzistojnë të dhëna për shkelje të rënda, të qëllimshme dhe të përsëritura. Në veçanti, kur ekzistojnë vendime administrative të formës së prerë që konfirmojnë detyrime të papaguara, ligji e trajton qartë subjektin si të papërshtatshëm për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Kur të dhënat shkojnë përtej mosshlyerjes së detyrimeve dhe lidhen me praktika të klasifikuara nga organet kompetente si evazioni fiskal, autoriteti kontraktor nuk mund të kufizohet në një verifikim formal, por duhet të ushtrojë detyrimin për verifikim të plotë dhe të thelluar pranë institucioneve përgjegjëse. Vetë ligji nr. 162/2020 Për prokurimin publik, në nenin 2 dhe nenin 3, vendos si objektiv dhe parim themelor jo vetëm efikasitetin dhe konkurrencën, por edhe garantimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Po kështu, neni 18 i këtij ligji ngarkon autoritetin kontraktor me detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e korrupsionit dhe për mbrojtjen e integritetit të procedurës. Në këtë kuptim, është e papranueshme që procesi i vlerësimit të reduktohet në një verifikim mekanik dhe formal të ekzistencës ose jo të detyrimeve tatimore në një moment të caktuar, por duhet të shtrihet edhe në vlerësimin e sjelljes së përgjithshme të operatorit ekonomik në raport me respektimin e legjislacionit në fuqi - ndërkohë që ekzistojnë të dhëna publike dhe indicie serioze për shkelje të rënda dhe të qëllimshme të legjislacionit fiskal nga operatori ekonomik. Në këtë kuptim, pranimi i konceptit se përjashtohet nga gara çdo operator që ka thjesht detyrime të pashlyera; por nuk përjashtohet një operator për të cilin ka të dhëna publike e mediatike për kryerjen e evazionit fiskal nga një operator i caktuar, krijon një disproporcion të dukshëm logjik dhe juridik. Situata mund të ilustruhet thjesht: nuk mund të mos pranosh në tavolinë një subjekt që ka një detyrim të zakonshëm financiar për shkak të pamundësisë së përkohshme të pagesës, ndërkohë që pranon një subjekt ndaj të cilit ka informacione për përfitim të paligjshëm dhe fshehje të qëllimshme të detyrimeve. Një qasje e tillë është qartazi e papranueshme dhe bie ndesh me vetë logjikën e integritetit të procedurës së prokurimit publik. Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor nuk mund të mbështetet vetëm në vetëdeklarime apo verifikime formale, por ka detyrimin të kryejë verifikime të plota dhe substanciale pranë institucioneve përgjegjëse, në mënyrë që të sigurojë se operatori ekonomik që do të shpallet fitues është jo vetëm formalisht i rregullt, por edhe realisht i besueshëm dhe në përputhje me standardet ligjore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve standartet të tenderit, kriteret e përzgjedhjes/kaulifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar;

Ofertuesi Deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;*
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.*
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.*

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

III.1.2. Nga shqyrtimi i informacioni dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor, për operatorin ekonomik “Kazazi Meat” SHPK, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit të subjektit Kazazi Meat Shpk datë 24.03.2026.

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin



Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
-	-	-	-
-	-	-	-
-	-	-	-

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
CHICKEN FARM ALBANIA sh.p.k	L33431801N	Mbeshtetje ne kapacitete ne furnizim me produkt	Furnizim me produkt mish pule sipas kontrates se furnizimit

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)



Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al), (Gjykata e Shkalës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës).

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë (Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID) :

Emri: V
Atesia: I
Amesia: .
Mbiemri: F
Datëlindja: .
Vendlindja: .
ID: .

Emri: .
Atesia: .
Amesia: .
Mbiemri: .
Datëlindja: .
Vendlindja: .
ID: .

etj,
nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al), (Gjykata e Shkalës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës).

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al), (www.app.gov.al)

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfutues në regjistrin e pronarëve përfutues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët

janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshiruar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al), (www.app.gov.al)

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit të subjektit Chicken Farm Albania Shpk datë 24.03.2026.

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
-	-	-	-
-	-	-	-
-	-	-	-

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatorit ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatorit ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
-	-	-	-
-	-	-	-

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.



Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al). (Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Durrës).

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë (Emër, atësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID) :

Emri: _____
 Atesia: _____
 Mbiemri: _____
 Datelindja: _____
 Vendlindja: _____
 ID: _____

Emri: _____
 Atesia: _____
 Mbiemri: _____
 Datelindja: _____
 Vendlindja: _____
 ID: _____

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al). (Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Durrës).

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al), (www.app.gov.al)

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al), (www.app.gov.al)

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (www.e-albania.al)

- Ekstrakt Historik dhe i Regjistrat Tregtar për subjektin "Kazazi Meat" Shpk datë 16.03.2026;

- Vërtetim (Për Statusin Aktiv/Pasiv/Të tjera) me nr. XXXX datë XXXXXXXX lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM për subjektin “Kazazi Meat” Shpk;
- Vërtetim nr – prot, datë XXXXXXXX, Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për z. Vasip Kazazi, i cili vërteton se nuk ndodhet në proces gjyqësor civil pranë kësaj gjykate;
- Vërtetim nr – prot, datë XXXXXXXX, Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për z. Jeti Kazazi, i cili vërteton se nuk ndodhet në proces gjyqësor civil pranë kësaj gjykate;
- Vërtetim nr – prot, datë XXXXXXXX, Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për subjektin “Kazazi Meat” Shpk i cili vërteton se nuk ndodhet në proces gjyqësor civil pranë kësaj gjykate;
- Vërtetim nr – prot, datë XXXXXXXX, Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për z. Vasip Kazazi, i cili vërteton se nuk ndodhet në proces gjyqësor penal pranë kësaj gjykate;
- Vërtetim nr – prot, datë XXXXXXXX, Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për z. Jeti Kazazi, i cili vërteton se nuk ndodhet në proces gjyqësor penal pranë kësaj gjykate;
- Vërtetim nr – prot, datë XXXXXXXX, Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për subjektin “Kazazi Meat” Shpk i cili vërteton se nuk ndodhet në proces gjyqësor penal pranë kësaj gjykate;
- Vërtetim (Për pagim detyrimesh) me nr. XXXXXXXX datë XXXXXXXX lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM për subjektin “Kazazi Meat” Shpk;
- Vërtetim (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin E-Sig 02/a) lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM me nr. XXXXXXXX datë XXXXXXXX për subjektin “Kazazi Meat” Shpk;
- Ekstrakt i Thjeshtë i Regjistrit të Pronarit Përfirues për subjektin “Kazazi Meat” Shpk me datë XXXXXXXX;

II.1.2. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5- vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur

personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kritereve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.1.3. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe

aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor

mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.5. Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e

përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastin konkret Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në këtë formular vetëdeklarimi, shtojca 9 e DST, vërehet se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK ka plotësuar të gjitha vendet të cilat janë të detyruara për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë. Në rastin konkret operatori ekonomik ka ofertuar sipas shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për paraqitjen e formularit të Vetëdeklarimit si provë paraprake lidhur me përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, kjo lidhur me momentin e hapjes së ofertave ku operatorët ekonomik si provë paraprake lidhur me kriteret e përgjithshme të kualifikimit plotësojnë formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe me pas hap pas njoftimit të fituesit paraprak operatori ekonomik i kualifikuar dorëzon dokumentacionin fizik pranë AK lidhur me këtë formular vetëdeklarimi, dokumentacion i cili është dorëzuar nga operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK dhe i administruar nga Komisioni Prokurimit Publik me shkresën nr. 1169/10 prot, datë 22.05.2026, gjithsej 143 faqe. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dhe shqyrtimi i dokumentave standarde të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar një afat kohor për vlefshmërinë e dokumentacionit para datës së hapjes së ofertave, siç pretendohet nga ankimuesi. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit të paraqesin dokumentacion sipas afatit të përcaktuar nga vetë ato, kërkesë e cila do të përbënte detyrim për t’u përmbushur nga ofertuesit, apo nëse do të ishte e përcaktuar qartë në Ligjin e Prokurimit Publik, ndërkohë operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin në përmbushje të kriterit të kërkuar nga AK, dokumentacion i cili është cituar në pikën III.1.2 të këtij vendimi. KPP gjykon se nga verifikimi i kryer, lidhur me mospërputhjen e deklarimit të kryer në Formularin e Vetëdeklarimit nga ana e operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar pranë AK, KPP gjykon se operatori ekonomik e ka përmbushur kriterin e përgjithshëm të kualifikimit me dokumentacionin e saktë të dorëzuar pranë AK me atë të deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Pasi dokumentacioni i pretenduar nga ankimuesi përmban datën para hapjes së ofertave. Edhe pse nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar një afat kohor për vlefshmërinë e dokumentacionit para datës së hapjes së ofertave, siç pretendohet nga ana e ankimuesit. Komisioni gjykon se, data e lëshimit të dokumentit provues nuk është, në vetvete, provë se gjendja juridike ose faktike nuk ka ekzistuar në datën e vetëdeklarimit, përveçse kur nga vetë dokumenti rezulton shprehimisht e kundërta ose kur kjo provohet nga autoriteti kompetent.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF, dokumentacionin e administruar gjatë procedurës së shqyrtimit administrativ, si dhe korrespondencën zyrtare të zhvilluar me administratën tatimore,

vlerëson se pretendimi i ankimesit se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK nuk plotëson kriterin e përgjithshëm të kualifikimit të parashikuar në germën (dh) të kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit, nuk rezulton i provuar, pasi Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimes e ka mbështetur pretendimin e tij mbi dyshimin se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK dhe subjekti mbështetës kanë pasur detyrime tatimore të papaguara në datën e dorëzimit të ofertave, pa paraqitur asnjë akt zyrtar të lëshuar nga administrata tatimore që të vërtetojë ekzistencën e këtyre detyrimeve në momentin juridik relevant. Pretendimet e ngritura në ankesë nuk mbështeten në prova konkrete, ndërkohë që, sipas parimeve të përgjithshme të procedimit administrativ dhe praktikës së konsoliduar të Komisionit, barra e provës për faktet që pretendohen i takon subjektit që i ngre ato. Pikërisht për të garantuar një shqyrtim sa më të plotë, objektiv dhe transparent të ankesës, në zbatim të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni pasi mori shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, ndërmoi një hetim administrativ duke iu drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore zyrtarisht me shkresë, përmes së cilës kërkoi informacion të detajuar lidhur me afatet ligjore të deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore, si dhe nëse operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK ka pasur detyrime të papaguara gjatë periudhës 16.12.2025 – 24.03.2026, periudhë që përfshin edhe datën e dorëzimit të ofertës. Nga përgjigjja zyrtare e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj rezulton se administrata tatimore ka sqaruar afatet ligjore të deklarimit dhe pagesës së secilit detyrim tatimor sipas legjislacionit në fuqi, dhe njëkohësisht ka deklaruar shprehimisht se **sistemi tatimor nuk ruan historikun e detyrimeve për një datë të caktuar**, duke e bërë objektivisht të pamundur konfirmimin nëse operatori ekonomik ka pasur ose jo detyrime të papaguara në periudhën e kërkuar nga Komisioni. Gjithashtu informon se **shoqëria Kazazi Meat shpk me NIPT K73609801E nuk është e rregjistruar për përgjegjësitë tatimore Taksa Kombëare dhe Tarifa Kombëtare**. Ky konstatim ka rëndësi thelbësore për zgjidhjen e çështjes, pasi kur vetë organi kompetent për administrimin dhe certifikimin e të dhënave tatimore nuk është në gjendje të konfirmojë ekzistencën e detyrimeve të papaguara në datën 24.03.2026. Për rrjedhojë, dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimes janë të pabazuara dhe u mungon prova mbi të cilën mund të mbështeten. Komisioni vlerëson se pamundësia objektive e administratës tatimore për të konfirmuar gjendjen historike të detyrimeve nuk mund të interpretohet në dëm të operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK dhe as të shërbejë si bazë për të prezumuar ekzistencën e një shkak skualifikimi. Nga ana tjetër, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në informacionin e përcjellë Komisionit Prokurimit Publik evidenton vetëm gjendjen e detyrimeve në datën 02.07.2026, duke sqaruar se ajo pasqyron situatën në kohë reale dhe jo gjendjen e operatorit ekonomik në periudhën objekt verifikimi. Ndaj për këtë arsye, kjo situatë nuk mund të përdoret si provë për të provuar një gjendje faktike që pretendohet të ketë ekzistuar disa muaj më parë. Pasi çdo interpretim i kundërt do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe me rregullat e administrimit të proves të parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative. Komisioni çmon se kriteri i parashikuar në nenin 76 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përbën një shkak përjashtues nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik dhe, si çdo shkak kufizues i së drejtës për të konkurruar, duhet të interpretohet ngushtësisht dhe të provohet me prova, objektive dhe të pakundërshtueshme.

Gjithashtu Komisioni konstaton se në ankesën e bërë nga ana e operatorit ekonomik ankimes ngrihen pretendime edhe mbi mos paraqitjen e dokumentacionit për vërtetueshmërinë e deklarimeve në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit nga ana e shoqërisë “*Chicken Farm Albania*” SHPK. Ky pretendim nuk gjen mbështetje pasi pavarësisht se operatori ekonomik “*Kazazi Meat*” SHPK në Formularin e tij Përmbledhës të Vetdeklarimit në Deklaratën B “*Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*” ka deklaruar si vijon:

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
CHICKEN FARM ALBANIA sh.p.k	L33431801N	Mbështetje në kapacitete në furnizim me produkt	Furnizim me produkt mish pule sipas kontratës së furnizimit
-	-	-	-

Një gjë e tillë nuk është deklaruar nga ana e “*Chicken Farm Albania*” SHPK në Formularin e tij Përmbledhës të Vetdeklarimit, sikurse është cituar në pikën III.1.3 të këtij vendimi, ç’ka është një detyrim ligjor që buron nga neni 84 “*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*” pika 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në të cilin përcaktohet se “*Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim*”. Përsa kohë një fakt i tillë nuk vërtetohet atëherë në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë me institutin e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera, pasi nuk plotësohet një nga kushtet kumulative siç është pika 3 e nenit 84, ku duhet dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. Shoqëria “*Kazazi Meat*” SHPK ka lidhur një marrëveshje furnizimi me shoqërinë “*Chicken Farm Albania*” SHPK në përmbushje të kriterit 2.3.7 të dokumenteve standarte të tenderit, kriter i cili ka parashikuar dy mekanizma të ndryshëm juridikë.

Së pari, autoriteti kontraktor ka parashikuar se, në rast se operatori ekonomik disponon licencën e kategorisë II.1.A.1, por emërtimi përshkrues i veprimtarisë nuk përfshin të gjithë artikujt objekt prokurimi, ai **duhet të disponojë kontratë furnizimi** nga një subjekt që zotëron licencën përkatëse për artikujt që vetë operatori nuk i mbulon.

Së dyti, autoriteti kontraktor ka parashikuar shprehimisht se **vetëm në rastet kur operatori ekonomik bashkëpunon me subjekte mbështetëse sipas nenit 84 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, këto subjekte duhet të plotësojnë kërkesat që ligji parashikon për subjektet mbështetëse.**

Vetë formulimi i kriterit demonstroi qartë se autoriteti kontraktor ka bërë dallim ndërmjet **kontratës së furnizimit** dhe **mbështetjes në kapacitete**, duke i trajtuar ato si dy situata juridike të ndryshme.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK disponon licencën e kategorisë II.1.A.1 dhe, për pjesën e artikullit “mish pule”, ka paraqitur një kontratë furnizimi me shoqërinë “Chicken Farm Albania” SHPK, për shkak se vetë nuk është prodhues i këtij produkti.

Komisioni vlerëson se kjo kontratë është paraqitur pikërisht në përmbushje të kërkesës së pikës 2.3.7 të dokumenteve të tenderit dhe nuk përbën, në vetvete, provë se operatori ekonomik është mbështetur në kapacitetet e këtij subjekti në kuptim të nenit 84 të ligjit.

Mbështetja në kapacitete ekziston vetëm kur operatori ekonomik përdor kapacitetet ekonomike, financiare, teknike ose profesionale të një subjekti tjetër për të provuar plotësimin e kriterëve të kualifikimit. Ndërsa kontrata e furnizimit, e kërkuar shprehimisht nga autoriteti kontraktor në rastet kur operatori ekonomik nuk prodhon ose nuk tregton një artikull të caktuar, përbën një mekanizëm kontraktual për sigurimin e furnizimit të mallrave gjatë ekzekutimit të kontratës dhe jo një rast mbështetjeje në kapacitete.

Pranimi i interpretimit të operatorit ekonomik ankimues do të çonte në përfundimin se çdo kontratë furnizimi e kërkuar nga dokumentet e tenderit do të konsiderohej automatikisht mbështetje në kapacitete sipas nenit 84 të ligjit, duke e bërë të panevojshëm dallimin që vetë autoriteti kontraktor ka bërë në kriteret e tenderit. Një interpretim i tillë do të binte ndesh me vullnetin e shprehur të autoritetit kontraktor dhe me parimin e interpretimit sistematik të dokumenteve të tenderit.

Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se marrëdhënia ndërmjet operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK dhe shoqërisë “Chicken Farm Albania” SHPK është krijuar në zbatim të kërkesës për paraqitjen e një kontrate furnizimi dhe jo si mbështetje në kapacitetet e një subjekti tjetër sipas nenit 84 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Në këto kushte, mungesa e dokumentacionit të parashikuar për subjektet mbështetëse nuk përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, pasi këto detyrime lindin vetëm në rastet kur operatori ekonomik zgjedh të mbështetet në kapacitetet e një subjekti tjetër për efekt të përmbushjes së kriterëve të kualifikimit.

Ndërsa sa i përket referimeve të operatorit ekonomik ankimues në raportime mediatike apo publikime në media lidhur me hetime ose dyshime për shkelje fiskale, Komisioni vlerëson se këto materiale nuk përbëjnë prova administrative ose juridike në kuptim të ligjit dhe nuk mund të zëvendësojnë informacionin zyrtar të administratës tatimore. Vlerësimi i plotësimit të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit bëhet mbi bazën e akteve dhe të dhënave zyrtare të organeve kompetente dhe jo mbi bazën e raportimeve mediatike apo perceptimeve subjektive të palëve.

Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të provojë ekzistencën e ndonjë shkaku skualifikimi sipas nenit 76 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin public”. Përkundrazi, hetimi administrativ i zhvilluar nga vetë Komisioni dhe përgjigjja e administratës tatimore nuk kanë nxjerrë asnjë provë zyrtare që të konfirmojë se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK ka pasur detyrime të papaguara në datën relevante të procedurës së prokurimit. Në mungesë të një prove të tillë, pretendimi i operatorit ekonomik “Argent Daci” PF mbetet i pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pranohet.

Për sa më sipër pretendimi operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Argent Daci” PF, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK me arsyetimin se: *“Kazazi-Meat shpk nuk ploteson kriterin pika 2.3.7 tek Kriteret e Vecanta te Kualifikimit. Sic është e njohur, referuar njoftimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE), publikohen vetëm të dhëna mbi kualifikimin ose skualifikimin e operatorëve ekonomikë, ndërsa, edhe pse palët e interesuara kanë të drejtë të parashtrojnë kontestime lidhur me rezultatet e procedurës, nuk vihet në dispozicion informacion i detajuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në këtë kuadër, duke iu referuar edhe përvojave të mëparshme të këtij operatori në procedura të prokurimit publik, krijohen dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. nuk përmbush në mënyrë të plotë kriterin themelor për kapacitetet teknike. 1. Siç jemi njohur nga padia e këtij subjekti ndaj një vendimi skualifikimi nga AK dhe KPP në një procedurë tjetër prokurimi nr REF-20171-09-17-2024, Kazazi Meat demonstroi se është e pajisur me licencat: - Kodi II.1.A.1, LN-4949-04-2018 prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për aktivitetin specifik përpunim mishi; - Kodi II.1.B, LN-4948-04-2018 shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (mish); - Kodi II.1.A.1 LN-7526-02-2014 prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (thertore). Por përgjatë procedurës së prokurimit operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. nuk kishte paraqitur licencën thelbësore që lidhet me përmbushjen e kriterit të kapaciteteve teknike, konkretisht licencën për prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz (thertore), e cila është element thelbësor i veprimtarisë objekt prokurimi. Nisur nga kjo indicie natyrshëm që në rastin konkret të kësaj procedure prokurimi të shpallur nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë janë dy mundësi që ose e ka paraqitur ose nuk e ka paraqitur këtë licencë nr LN-7526-02-2014 për prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (thertore). Referuar Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), kriteri 2.3.7 përcakton shprehimisht se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licencë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit, konkretisht: Për operatorët ekonomikë vendas kërkohet licencë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), përfshirë kategorinë II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, dhe nënkategorinë II.1.A.1 Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Në vijim, analiza e këtij rasti kërkon domosdoshmërisht verifikimin e saktë të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në procedurën objekt ankimi, duke u bazuar në dy skenarë të mundshëm faktikë dhe juridikë. Nëse Kazazi*

Meat si në rastet e mëparshme, për përmbushjen e kriterit teknik ka paraqitur licencën për përpunim mishi e jo atë për thertore atëherë kjo licencë nuk përmbush kriterin 2.3.7 të DST. Për të demonstruar përmbushjen e kriterit të përcaktuar në DST, nëse operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. , ashtu si në raste të mëparshme, ka paraqitur vetëm licencën Kodi II.1.A.1, LN-4949-04-2018 prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për veprimtarinë specifike përpunim mishi , rezulton se kjo licencë nuk përmbush kërkesën e përcaktuar në kriterin 2.3.7 të DST-së. Ky kriter parashikon shprehimisht se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licencë me emërtim përshtatës të veprimtarisë, në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit, pra që lidhet me prodhimin dhe/ose tregtimin e mishit sipas kërkesave të kontratës. Në rastin konkret, licenca e paraqitur pasqyron qartazi se veprimtaria e autorizuar për operatorin është përpunim mishi , e cila nuk është ekuivalente me veprimtarinë e kërkuar në procedurën objekt ankimi, që lidhet me prodhimin dhe furnizimin me mish të freskët për konsum njerëzor. Kjo rezulton edhe nga akti i miratimit të kërkesës për licencim, sipas shkresës nr. 2041/2 prot., datë 28.06.2021 të AKU-së, ku përcaktohet se licenca është dhënë për veprimtarinë përpunim mishi , bazuar në verifikimet në vend të inspektorëve kompetentë të AKU-së, të cilët kanë konfirmuar përmbushjen e kriterëve për këtë lloj aktiviteti. Pra, përmes kësaj licence, operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. vërteton se është i licencuar për përpunimin e mishit (kryesisht të mishit të ngrirë dhe produkteve të tij), si dhe për tregtimin e produkteve të përpunuara, por jo për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit dhe furnizimit me mish të freskët sipas objektit të procedurës së prokurimit. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të dallohet qartë midis dy llojeve të stabilimenteve: Stabilimenti i përpunimit të mishit: Ka si funksion përpunimin e mishit të përfutur nga burime të tjera, si dhe prodhimin e produkteve të sallamerisë dhe produkteve të marinuara; Proceset kryesore përfshijnë përgatitjen e brumit të produkteve, shtimin e erëzave, aditivëve dhe konservantëve, si dhe procese si tymosje, tharje, marinim dhe paketim; Operon nën kërkesa të larta higjieno-sanitare për parandalimin e kontaminimit të produkteve të përpunuara. Stabilimenti i prodhimit të mishit (thertore): Ka si funksion therjen e kafshëve dhe prodhimin e mishit të freskët; Proceset kryesore përfshijnë therjen, heqjen e organeve të brendshme, prerjen dhe përgatitjen për shpërndarje të menjëhershme; Operon nën standarde shumë të rrepta higjieno-sanitare dhe kontroll të vazhdueshëm veterinar, për shkak të riskut të lartë të ndotjes bakteriale dhe afateve shumë të shkurtra të ruajtjes dhe tregtimit (deri në 7 ditë). Nga ky dallim rezulton qartë se licenca e paraqitur nga operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. , që lidhet me përpunimin e mishit, nuk mund të konsiderohet si përmbushje e kriterit për kapacitet teknik për prodhimin dhe furnizimin me mish të freskët, siç kërkohet në mënyrë eksplicite nga DST. Në të kundërt, kjo licencë dëshmon vetëm kapacitetin e operatorit për: sigurimin e lëndës së parë (mish të ngrirë apo produkte shtazore) për përpunim; kryerjen e proceseve teknologjike të përpunimit (marinim, kriposje, aditivim, konservim); garantimin e kushteve për përpunim dhe paketim të produkteve të përpunuara; por nuk provon kapacitetin për: prodhimin dhe furnizimin me mish të freskët; ushtrimin e aktivitetit të therjes dhe tregtimit të mishit të freskët; menaxhimin e zinxhirit të furnizimit nën regjim të rreptë kohor dhe temperaturash, siç kërkohet për mishin e freskët. Këto elemente janë objektivisht të dallueshme dhe të përcaktuara në aktet e licencimit, dhe nuk përbëjnë interpretime subjektive, por rrjedhojë të drejtpërdrejtë të përmbajtjes së licencës dhe procedurës së miratimit të saj. Në këtë drejtim, në një qëndrim

zyrtar të Agjencisë Kombëtare të Ushqimit (AKU), përcjellë me shkresën nr. 411/1 prot., datë 04.03.2022, është sqaruar se licenca e kategorisë II.1.A, me veprimtari prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz me nënkategori thertore, lidhet me aktivitetin e thërjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit të freskët. (Bashkangjitur Shkresa). Për te vertetuar kete fakt subjekti yne i eshte drejtuar ne daten 24.02.2025 Autoritetit Kombetar te Ushqimit me shkresen Nr 1258 prot te tyren me kerkesen per interpretim lidhur me pyetjen: A mundet qe nje subjekt qe eshte licencuar me licence te tipit II.I.A.1 Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumice e ushqimeve per njerez me kufizime specifike te licences Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumice e ushqimeve per njerez Perpunim Mishi, te ushtroje veprimtarine Prodhim dhe shpërndarje me shumice e mishit te vicit fresket ?. Autoriteti Kombetar i Ushqimit me shkresen Nr 1701 prot date 18.03.2025 ka kthyer pergjigjen si me poshte: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumice e ushqimeve per njerez me kodin II.I.A.1 me aktivitetin specifik (përpunim mishi) nuk mundet te ushtroje veprimtarine ne aktivitetin Prodhim, dhe shpërndarje me shumice te mishit te fresket (bashkangjitur shkresa e AKU). Në këtë kuptim, çdo përpjekje për të barazuar licencën e përpunimit të mishit me licencimin për prodhim dhe furnizim me mish të freskët është objektivisht e pabazuar dhe në kundërshtim me vetë përmbajtjen e akteve të licencimit. Rrjedhimisht, pretendimi për përmbushjen e kriterit 2.3.7 mbi bazën e kësaj licence rezulton i pambështetur dhe çon në përfundimin se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e kapaciteteve teknike të kërkuara nga DST për këtë procedurë prokurimi. Edhe nëse Kazazi Meat ka paraqitur licencën për thertore, ekziston domosdoshmëria e verifikimit substancial të kapacitetit teknik. Nëse operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. ka paraqitur edhe licencën LN-7526-02-2014 prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (thertore) , atëherë, në mënyrë formale, do të konsiderohej se është plotësuar kriteri 2.3.7 i DST-së, pasi kjo licencë përmban emërtimin përshkrues të veprimtarisë në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit. Mirëpo, një konstatim i tillë formal nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm dhe nuk përjashton detyrimin për verifikim të plotë dhe substancial të kapacitetit real teknik të operatorit ekonomik. Sikurse është parashtruar edhe më sipër, nga praktikatat e mëparshme të pjesëmarrjes së këtij operatori në procedura të tjera prokurimi, me interes dhe vlerë ekonomike të konsiderueshme, rezulton se Kazazi Meat sh.p.k. nuk e ka paraqitur këtë licencë (LN-7526-02-2014), ndonëse e ka disponuar atë. Në këto kushte, lindin natyrshëm dy pyetje thelbësore: përse kjo licencë nuk është paraqitur në procedurat e mëparshme të prokurimit publik; dhe përse paraqitet në këtë procedurë konkrete. Nga këto rrethana krijohet një indicie e arsyeshme se dokumentacioni mbi kapacitetet teknike paraqitet në mënyrë jo konsistente, çka kërkon domosdoshmërisht verifikim të thelluar nga autoriteti kontraktor. Në mënyrë logjike, mosparaqitja e kësaj licence në procedura të mëparshme ngre dyshime të arsyeshme se mund të ekzistojnë një ose më shumë nga këto rrethana, ndër të tjera: mungesë e titullit të ligjshëm të përdorimit të stabilimentit (pronësi ose kontratë noteriale qiraje/përdorimi); mungesë e përmbushjes së kërkesave ligjore për funksionimin e thertoresh; ose ekzistenca e një stabilimenti që nuk është i legalizuar apo i pajisur plotësisht me lejet përkatëse. Në procedurat e mëparshme të prokurimit, ky element ka qenë i përcaktuar shprehimisht si kriter kualifikimi, ku kërkohej që operatori ekonomik të disponojë minimalisht një stabiliment në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 Për ushqimin , i ndryshuar, dhe për këtë qëllim të paraqesë certifikatë

pronësie ose kontratë noteriale qiraje/përdorimi të vlefshme. Edhe pse në procedurën objekt ankimi kjo kërkesë nuk është e detajuar në të njëjtën mënyrë, nga pikëpamja substanciale e kapacitetit teknik, Autoriteti Kontraktor nuk mund të kufizohet në verifikimin formal të ekzistencës së një licence, por ka detyrimin të vlerësojë nëse ekziston realisht dhe në mënyrë të ligjshme kapaciteti për ushtrimin e aktivitetit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Në këtë kuptim, fakti i disponimit formal të licencës nuk garanton në vetvete që operatori ekonomik do të ketë në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurt në dispozicion stabilimentin përkatës gjatë zbatimit të kontratës. Rreziqet praktike që mund të materializohen gjatë ekzekutimit të kontratës janë reale dhe përfshijnë, ndër të tjera: ndërprerjen e përdorimit të stabilimentit për shkak të mungesës së titullit ligjor mbi ambientin; ndërhyrje nga autoritetet kompetente për shkak të ndërtimeve pa leje ose mospërbushjes së standardeve ligjore; ose ndërprerje të aktivitetit për shkaqe të pavarura nga autoriteti kontraktor, duke krijuar pamundësi objektive për realizimin e kontratës. Në këto kushte, kur vetë ekzistenca dhe disponueshmëria e stabilimentit nuk është e garantuar në mënyrë të ligjshme dhe të qëndrueshme (për shkak të mungesës së pronësisë, kontratës së vlefshme të përdorimit apo përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi), kontrata që mund të lidhet me këtë operator rezulton në thelb e pasigurt dhe e ekspozuar ndaj ndërprerjes, pra një kontratë në ajër. Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor jo vetëm që nuk ka ndalesë, por ka detyrimin të verifikojë jo thjesht ekzistencën formale të licencës (si dokument), por ekzistencën reale dhe të ligjshme të kapacitetit teknik që ajo pretendon të mbulojë. Në të kundërt, do të krijohej një situatë ku, për shkaqe të mundshme si humbja e posedimit të ambientit nga operatori, ndërhyrja e autoriteteve për prishje të ndërtimeve të paligjshme apo pezullimi i aktivitetit, kontrata do të bëhej e pazbatueshme, ndërkohë që operatori ekonomik do të mund të shmangte përgjegjësinë duke u mbështetur në rrethana të jashtme, duke pretenduar se këto rreziqe nuk i atribuohen atij dhe nuk janë nën kontrollin e tij (nuk më pyetet lidhur me këtë risk). Kjo situatë sjell në praktikë kalimin e riskut të ekzekutimit nga operatori ekonomik te Autoriteti Kontraktor, duke e bërë kontratën të pasigurt në zbatim. Për rrjedhojë, edhe në rastin e paraqitjes formale të licencës LN-7526-02-2014, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të mos kufizohet në një vlerësim thjesht dokumentar, por të kryejë verifikim të plotë dhe substancial të ekzistencës dhe ligjshmërisë së stabilimentit, përmes korrespondencës me institucionet përkatëse, në funksion të garantimit të sigurisë së kontratës dhe shmangies së riskut në zbatim. Në përfundim, nga analiza e mësipërme rezulton se, pavarësisht se cili nga dy skenarët qëndron në fakt, rezultati juridik mbetet i njëjtë. Në rast se operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. nuk ka paraqitur licencën përkatëse për thertore, atëherë ai nuk përmbush kriterin e kapaciteteve teknike të përcaktuar në DST dhe duhet të skualifikohet. Nga ana tjetër, edhe nëse kjo licencë është paraqitur në mënyrë formale, rrethanat e evidentuara lidhur me paraqitjen jo konsistente të saj në procedura të mëparshme dhe mungesa e garancisë mbi ekzistencën dhe disponueshmërinë reale të stabilimentit imponojnë detyrimin për verifikim të thelluar, në mungesë të të cilit kualifikimi i operatorit nuk mund të konsiderohet i ligjshëm. Për rrjedhojë, në të dyja rastet, pranimi dhe kualifikimi i operatorit ekonomik në këtë procedurë bie ndesh me kërkesat e DST-së dhe parimet e prokurimit publik, duke e bërë të domosdoshëm skualifikimin e tij”, Komisioni i Prokurimit Publik

III.2.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është përcaktuar si vijon:

2.3.7 *Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të procedurës së prokurimit:*

Për OE/BOE vendas:

Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Për OE/BOE e huaj:

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme për veprimtarinë e ushtruar sipas kërkesës së mësipërme, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës. Në këtë licencë duhet të jetë qartësisht e dallueshme veprimtaria përshkruese sipas këtij kriteri.

Në rast se OE disponon licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” por emërtimi përshkrues i veprimtarisë nuk është në përputhje me të gjithë artikujt objekt prokurimi, OE duhet të disponojë kontratë /a furnizimi nga subjekte që e zotërojnë licensën e sipërcituar me emërtimin përshkrues të veprimtarisë për pjesën e artikujve që nuk disponohen nga vet OE konkurrues.

Edhe në rastet kur OE do të bashkëpunojnë me subjekte mbështetëse, sipas parashikimeve të nenit 84 të LPP, këta të fundit duhet të disponojnë licencën me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të prokurimit, pjesës që do të mbulojnë.

Në cdo rast OE duhet të disponojë licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” me emërtimin përshkrues të veprimtarisë i cili duhet të jetë në përputhje me të pakten njerin prej objekteve të prokurimit.

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike ka dorëzuar dokumentacionin si vijon

- Licencë LN-4949-04-2018, Nuis/Nipt K73609801E, Kazazi Meat shpk, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Komuna Golem, Fshati Kanapara, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale nr. 2071, Pasuria nr. 744. Kodi II.1.A.1, data e lëshimit 20.04.2018, Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, Nënkategoria: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, Veprimtari specifike: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim, ambalazhim etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku Tiranë, Rrethi Kavajë, Komuna Golem, Fshati Kanapara, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale nr. 2071, Pasuria nr. 744.

- Akt Miratimi nr. 2041/2 prot, datë 28.06.2021 me përmbajtje [....].... Subjekti Kazazi Meat shpk, Qarku Tiranë me Nuis/Nipt K7.609801E, numër licence në zotërim KL-4949-04-2018 dhe aktivitet: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve dhe veprimtari

specifike “Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve (përpunim mish)”, ka aplikuar për ndryshim të drejtuesit teknik, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Në bazë të shkresës nr. 1110/1 prot, datë 21.06.2021, të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Tiranë paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së subjektit është kryer inspektimi nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezulton: Subjekti Kazazi Meat shpk plotëson kushtet dhe kriteret përkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licensim.

- Licencë LN-4948-04-2018, Nuis/Nipt K73609801E, Kazazi Meat shpk, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Komuna Golem, Fshati Kanaparaj, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale nr. 2071, Pasuria nr. 744. Kodi II.1.B, data e lëshimit 20.04.2018, Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, Nënkatëgoria: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz), Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (mish). Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku Tiranë, Rrethi Kavajë, Komuna Golem, Fshati Kanaparaj, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale nr. 2071, Pasuria nr. 744.

- Akt Miratimi nr. 2392/2 prot, datë 20.04.2018 me përmbajtje [....].... Subjekti Kazazi Meat shpk, Qarku Tiranë me Nuis/Nipt K7.609801E, dhe aktivitet “Prodhim dhe/ose tregtimi i ushqimeve”, dhe veprimtari specifike “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (mish)”, ka aplikuar për pajisje me licensë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Në bazë të shkresës nr. 783/1 prot, datë 12.04.2021 të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Tiranë, paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, subjektit i është kryer inspektim nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezulton: Subjekti kazazi Meat SHPK, plotëson kushtet dhe kriteret përkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licensim.

- Kontratë Funizimi lidhur më datë 04.03.2026 mes palëve kontraktuese shitësi “Chicken Farm Albania” SHPK dhe blerësi “Kazazi Meat” SHPK. Në nenin 1 Objekti i Marrëveshjes. Objekti i kësaj kontrate është furnizimi nga ana e shitësit me mbi 38636 kg mish pule, e shpërndarë sipas nevojave të blerësit në njëhark kohorë prej 12 muajsh. Blerësi pranon të furnizohet me mbi 38.636 kg mish pule, e shpërndarë sipas nevojave të blerësit në një hark prej 12 muajsh.

- Licencë LN-0944-08-2020, Nuis/Nipt L33431801N, Chicken Farm Albania shpk, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Tiranë, Kavajë, Agonas. Kodi II.1.A.1, data e lëshimit 04.08.2020, Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, Nënkatëgoria: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, Veprimtari specifike: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Thertore, prodhim, përpunim, ambalazhim etiketim dhe shpërndarje me shumicë e mishit dhe nënprodukteve të tij. Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku Tiranë, Rrethi Kavajë, Fshati Agonas, Zona Kadastrale nr. 3961, Pasuria nr. 730/1.

- Akt Miratimi nr. 5326/3 prot, datë 07.11.2024 me përmbajtje [....].... Subjekti Chicken Farm Albania shpk, Qarku Tiranë me Nuis/Nipt L33431801N, numëri i titullit të licensës në zotërim LN-0944-08-2020, me aktivitet: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, veprimtari specifike “Thertore (mish i bardhë), prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e mishit dhe nënprodukteve të tij”, ka aplikuar për ndryshim të drejtuesit teknik, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Në

bazë të shkresës nr. 10933/1 prot, datë 31.10.2024, të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Tiranë paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së subjektit i është kryer inspektimi nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezultoni: Subjekti Chicken Farm Albania shpk plotëson kushtet dhe kriteret përkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licensim.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Në nenin 3, “Parime të përgjithshme”, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.2.5. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

III.2.7. Neni 40, pika 5 i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.2.8. Në nenin 3, pika 16, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes” është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë”

III.2.9. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.

III.2.10. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”

Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orientuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emertimi i 15 veprimtarise(ve) specifike te licencuara sqarohet se:

- a) Ketu vendoset emertimi i veprimtarise specifike kur kjo eshte e kodifikuar.
- b) Kur subjekti ka kerkuar te ushtroje me shume se nje veprimtari specifike, ketu vendosen

emeritimet e te gjitha atyre veprimtarive specifike qe ka kerkuar te licencohen.

c) Nese keto shenime kerkojne me shume se 250 karaktere atehere vihet shenimi:

Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkelidhur Nr.....”.

III.2.11. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, parashikohet shprehimisht:

Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti

4 1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare

6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare

III.2.12. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht:

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së

Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

III.2.13. Në nenin 17, “Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.

2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.

3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;

b) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;

c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;

ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimit apo përdorimit të së mirës;

d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;

dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);

e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;

ë) adresën për komunikim;

f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

III.2.14. Në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.

2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emrin dhe stemën e QKL-së;

b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;

c) të dhënat për identifikimin e titullarit;

ç) llojin e veprimtarisë, veprimit apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;

d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë);

dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimit apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka);

e) afatin e vlefshmërisë;

ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit;

f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë;

g) aneksin.

3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

III.2.15. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të

zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.16. Referuar sa më lart, vërehet, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka përcaktuar konkretisht se 2.3.7 2.3.7 *Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të procedurës së prokurimit: Për OE/BOE vendas: Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme: Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Në rast se OE disponon licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” por emërtimi përshkrues i veprimtarisë nuk është në përputhje me të gjithë artikujt objekt prokurimi, OE duhet të disponojë kontratë /a furnizimi nga subjekte që e zotërojnë licencën e sipërcituar me emërtimin përshkrues të veprimtarisë për pjesën e artikujve që nuk disponohen nga vet OE konkurrues. Edhe në rastet kur OE do të bashkëpunojnë me subjekte mbështetëse, sipas parashikimeve të nenit 84 të LPP, këta të fundit duhet të disponojnë licencën me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të prokurimit, pjesës që do të mbulojnë. Në cdo rast OE duhet të disponojë licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” me emërtimin përshkrues të veprimtarisë i cili duhet të jete në përputhje me te pakten njerin prej objekteve të prokurimit.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kazazi Meat” ShPK në përmbushje të kriterit më sipër, konstatohet se është dorëzuar në përputhje me kërkesat në kriteret e kualifikimit për licencimin e shoqërisë. Konkretisht është paraqitur - *Licencë LN-4949-04-2018, Nuis/Nipt K73609801E, Kazazi Meat shpk, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Komuna Golem, Fshati Kanaparaj, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale nr. 2071, Pasuria nr. 744. Kodi II.1.A.1, data e lëshimit 20.04.2018, Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, Nënkatëgoria: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, Veprimtari specifike: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim, ambalazhim etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku Tiranë, Rrethi Kavajë, Komuna Golem, Fshati Kanaparaj, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale nr. 2071, Pasuria nr. 744. - Akt Miratimi nr. 2041/2 prot, datë 28.06.2021 me përmbajtje [...].... Subjekti Kazazi Meat shpk, Qarku Tiranë me Nuis/Nipt K7.609801E, numër licence në zotërim LN-4949-04-2018 dhe aktivitetet: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve dhe veprimtari specifike “Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe*

shpërndarje me shumicë e ushqimeve (përpunim mishi)”, ka aplikuar për ndryshim të drejtuesit teknik, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Në bazë të shkresës nr. 1110/1 prot, datë 21.06.2021, të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Tiranë paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së subjektit është kryer inspektimi nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezulton: Subjekti Kazazi Meat shpk plotëson kushtet dhe kriteret përkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licensim. - Licencë LN-4948-04-2018, Nuis/Nipt K73609801E, Kazazi Meat shpk, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Komuna Golem, Fshati Kanaparaj, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale nr. 2071, Pasuria nr. 744. Kodi II.1.B, data e lëshimit 20.04.2018, Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, Nënkatëgoria: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz), Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (mish). Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku Tiranë, Rrethi Kavajë, Komuna Golem, Fshati Kanaparaj, Ura e Leshniqës, Zona Kadastrale nr. 2071, Pasuria nr. 744. - Akt Miratimi nr. 2392/2 prot, datë 20.04.2018 me përmbajtje [....].... Subjekti Kazazi Meat shpk, Qarku Tiranë me Nuis/Nipt K7.609801E, dhe aktivitet “Prodhim dhe/ose tregtimi i ushqimeve”, dhe veprimtari specifike “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (mish)”, ka aplikuar për pajisje me licensë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Në bazë të shkresës nr. 783/1 prot, datë 12.04.20218 të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Tiranë, paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, subjektit i është kryer inspektim nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezulton: Subjekti kazazi Meat SHPK, plotëson kushtet dhe kriteret përkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licensim. Ndërsa për zërin mish pule objekt prokurimi ka paraqitur - Kontratë Funizimi lidhur më datë 04.03.2026 mes palëve kontraktuese shitësi “Chicken Farm Albania” SHPK dhe blerësi “Kazazi Meat” SHPK. Në nenin 1 Objekti i Marrëveshjes. Objekti i kësaj kontrate është furnizimi nga ana e shitësit me mbi 38636 kg mish pule, e shpërndarë sipas nevojave të blerësit në njëhark kohorë prej 12 muajsh. Blerësi pranon të furnizohet me mbi 38.636 kg mish pule, e shpërndarë sipas nevojave të blerësit në një hark prej 12 muajsh. - Licencë LN-0944-08-2020, Nuis/Nipt L33431801N, Chicken Farm Albania shpk, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Tiranë, Kavajë, Agonas. Kodi II.1.A.1, data e lëshimit 04.08.2020, Kategoria: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, Nënkatëgoria: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, Veprimtari specifike: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Thertore, prodhim, përpunim, ambalazhim etiketim dhe shpërndarje me shumicë e mishit dhe nënprodukteve të tij. Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku Tiranë, Rrethi Kavajë, Fshati Agonas, Zona Kadastrale nr. 3961, Pasuria nr. 730/1. - Akt Miratimi nr. 5326/3 prot, datë 07.11.2024 me përmbajtje [....].... Subjekti Chicken Farm Albania shpk, Qarku Tiranë me Nuis/Nipt L33431801N, numëri i titullit të licencës në zotërim LN-0944-08-2020, me aktivitet: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, veprimtari specifike “Thertore (mish i bardhë), prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumicë e mishit dhe nënprodukteve të tij”, ka aplikuar për ndryshim të drejtuesit teknik, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Në bazë të shkresës nr. 10933/1 prot, datë 31.10.2024, të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Tiranë paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së subjektit i është kryer inspektimi nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezulton: Subjekti Chicken Farm Albania shpk plotëson kushtet dhe kriteret përkatëse ligjore për zhvillimin e

aktivitetit të kërkuar për licensim.

Referuar proces-verbalit të argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton, se autoriteti kontraktor për kriterin e mësipërm ka arsyetuar shprehimisht **“Argumentimi: Është kërkuar që OE konkurues duhet të disponojë Licensa të lëshuara nga QKB: Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Kjo është Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme, sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit. Për këtë arsye, lind e nevojshme që të garantohet AK dhe të krijojë bindjen se furnizimi i ushqimit do të jetë i pandërprerë. Kontratat e furnizimit sigurojnë AK që në rastin kur ofertuesi nuk ka veprimtarinë e licensës II 1 A 1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të gjithë artikujt objekt prokurimi, të ketë një marrëveshje të qëndrueshme me subjekte të licensuar me licensën II 1 A 1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” për atë artikull që mungon, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve në furnizim. Kontratat e furnizimit gjithashtu janë tregues edhe për një marrëdhënie të qëndrueshme me këto subjekte të licensuar dhe ky fakt mund të ndihmojë në garantimin e cilësisë së produktit, pasi këto subjekte janë të angazhuar për të përmbushur standardet e kërkuara duke qënë se janë të licensuar në atë fushë veprimtarie. Gjithashtu ky kriter është në përputhje me Vendimin Nr.23/2026, datë 07.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.**

Kështu, në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. **Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës**”. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar se kërkesat e vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit duhet të jenë në proporcion me objektin e kontratës. Nga ana tjetër, vetë autoriteti kontraktor në arsyetimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me këtë kriter ka arsyetuar se **kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore**. Në rastin konkret, objekti i kontratës objekt prokurimi është blerja e mish vici dhe mish pule, ndërkohë referuar licencave të dorëzuara në SPE nga ana e operatorit ekonomik, rezulton se ky i fundit disponon dy licenca me veprimtari specifike Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve (përpunim mishi) dhe “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (mish).

Me Vendimin nr. 457 datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit” rezulton se mishi viçi dhe mish pule është në kategorinë e kodeve të veprimtarive të Produkte ushqimore, pije, duhan dhe të lidhura me to: **15000000-8, sikurse dhe kodi i përzgjedhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit është: Mish viçi**

15111200-1 kode që hynë në kategorinë e Produkteve ushqimore, pije, duhan dhe lidhura me to kategori në të cilën bën pjesë edhe objekti i lotit të I objekt shqyrtimi blerje mish viçi dhe mish pule. Gjithashtu, në ligjin nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Aneksin 3 “Përmbajtja orinetuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emërtimi i veprimtarisë-ve) specifike të licencuara sqarohet se: a) Këtu vendoset emërtimi i veprimtarisë specifike kur kjo është e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kërkuar ëe ushtrojë më shumë se një veprimtari specifike, këtu vendosen emërtimet e të gjitha atyre veprimtarive specifike që ka kërkuar të licencohen. c) Nëse këto shënime kërkojnë më shumë se 250 karaktere atëherë vihet shënimi: Për llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr.....”.

Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se objekti i prokurimit të procedurës objekt-ankimi është “Blerje mish viçi dhe mish pule”, dhe autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit”. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se në rast se OE disponon licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” por emërtimi përshkruar i veprimtarisë nuk është në përputhje me të gjithë artikujt objekt prokurimi, OE duhet të disponojë kontratë /a furnizimi nga subjekte që e zotërojnë licensën e sipërcituar me emërtimin përshkruar të veprimtarisë për pjesën e artikujve që nuk disponohen nga vet OE konkurrues.

Pra referuar përcaktimit të bërë nga ana e autoritetit kontraktor në kriterin kualifikues rezulton se vetë formulimi i kriterit demonstroi qartë se autoriteti kontraktor ka bërë dallim ndërmjet **kontratës së furnizimit dhe mbështetjes në kapacitete**, duke i trajtuar ato si dy situata juridike të ndryshme. Pikërisht në zgjerim të konkurrencës autoriteti ka parashikuar se nëse emërtimi përshkruar i veprimtarisë nuk është në përputhje me të gjithë artikujt objekt prokurimi (mish viçi dhe mish pule) operatorët ekonomik duhet të disponojë kontratë /a furnizimi nga subjekte që e zotërojnë licensën e sipërcituar me emërtimin përshkruar të veprimtarisë për pjesën e artikujve që nuk disponohen nga vet OE konkurrues. Në rastin konkret, rezulton e provuar nëpërmjetë dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK është i pajisur me licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve (përpunim mishi)”, ndërsa sa i përketë mishit të pulës ka deklaruar se këtë artikull do ta disponojë nëpërmjetë kontratës së furnizimit me shoqërinë “Chicken Farm Albania” SHPK për të cilën ka dorëzuar edhe licencën përkatëse sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Sa më sipër, rezulton, se operatori ekonomik është i licencuar dhe disponon kapacitet për veprimtarinë e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK është në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon Licencës së kategorisë II.1.A.1 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pasi nga verifikimi rezulton, se në Licencën II.1.A. me të cilën është pajisur ky operator ekonomik, veprimtarinë specifike të përshkruar në licencë është “Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve (përpunim mishi)”, sipas objektit të prokurimit. Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të

cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*; *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin: a) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”*, KPP gjykon se operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK ka dorëzuar licencat e kategorisë II.1.A për sa i përket veprimtarisë specifike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në këtë kuptim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik “Kazazi Meat” SHPK nuk qëndron, pasi ky operatori ekonomik arrin të provojë se disponon licencë II.1.A me fushë veprimtarie specifike prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje të ushqimeve për njerëz, (përpunim mishi).

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”* Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të kërkuar është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Sa më lart arsyetuar, me dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor të përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit “Kapaciteti teknik” dhe për rrjedhojë ky dokumentacion konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” Shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Argent Daci” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *“Mbi skualifikimin per*

anomalisht të ulët të ofertës së OE Kazazi Meat sh.p.k. dhe detyrimin për refuzimin e saj. Nga publikimi i vendimit të KVO rezulton se operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. ka ofertuar çmimin - 900 lekë/kg me TVSH për mish të freskët viçi. Ndërkohë, referuar të dhënave zyrtare të INSTAT; në shtator 2025 çmimi minimi i mishit të freskët të viçit ka qenë 1167 lekë/kg me TVSH; në shkurt 2026 ka arritur në minimalisht 1201 lekë/kg me TVSH. Pra, oferta e paraqitur është ndjeshëm më e ulët jo vetëm ndaj mesatares së tregut, por edhe ndaj çdo reference minimale reale, çka e bën atë qartazi dhe objektivisht anomalisht të ulët. Ky konkluzion përforcohet edhe më tej nga konteksti ekonomik aktual, ku për shkak të zhvillimeve ndërkombëtare (luftërave botërore) dhe rritjes së kostove në zinxhirin e furnizimit tendenca e çmimeve është në rritje, jo në ulje. Në këto kushte, një ofertë kaq e ulët nuk përbën thjesht një ofertë konkurruese, por një devijim të pajustificueshëm nga realiteti ekonomik i tregut. Në këto kushte, aktivizohet drejtpërdrejt neni 93 i ligjit nr. 162/2020, i cili përcakton se: kur oferta është anomalisht e ulët, autoriteti kontraktor ka detyrimin të kërkojë shpjegime (pika 1); dhe më tej, duhet ta refuzojë ofertën nëse nuk bindet për rregullshmërinë e saj (pika 3). ndërkohë, sipas VKM nr. 285/2021, neni 82, KVO ka detyrimin: të identifikojë ofertat anomalisht të ulëta sipas formulës përkatëse; dhe, në varësi të vlerës së procedurës, t i refuzojë ose të kërkojë shpjegime të detyrueshme. Edhe në rastin kur aplikohet formula standarde, ajo nuk mund të përdoret si alibi për të anashkaluar një realitet të dukshëm: kur një ofertë është në mënyrë flagrante jashtë çdo logjike tregu, anomalia është e evidente aqik dhe kërkon trajtim substancial, jo formal. Asnjë nga elementet e parashikuara në nenin 93, pika 2, nuk mund të justifikojë këtë nivel çmimi: nuk rezulton ndonjë avantazh ekonomik i jashtëzakonshëm real; nuk ka zgjidhje teknike apo metodologjike që ulin në këtë masë koston e mishit të freskët; nuk ka asnjë indicie për origjinalitet apo inovacion në furnizim; përkundrazi, një çmim i tillë ngre dyshime serioze për mosrespektim të detyrimeve ligjore, përfshirë ato fiskale dhe të sigurisë ushqimore. Në këto kushte, mbetet logjikisht vetëm dy mundësi: ose oferta mbështetet në praktika të paligjshme (p.sh. evazion fiskal, siç rezulton nga problematikat e evidentuara më sipër për këtë operator); ose furnizimi nuk do të realizohet me mish viçi të freskët sipas specifikimeve, por me produkte të tjera gjoja te ngjashme si psh mish lope ne vend tee mishit tee vicit, në shkelje të kontratës. Të dyja këto alternativa janë të papranueshme ligjrisht. Edhe jashtë analizës strikte ligjore, situata është lehtësisht e kuptueshme: askund në tregun shqiptar nuk mund të sigurohet mish viçi i freskët me 900 lek/kg me TVSH; me asnjë konsumator racional sado qe gjithnje eshte i interesuar peer cmimin me te ulet, nuk do të besonte një ofertë të tillë pa dyshime serioze mbi cilësinë dhe origjinën e produktit. Kjo tregon se nuk kemi të bëjmë me një ofertë konkurruese, por me një ofertë që bie ndesh me vetë logjikën bazë të tregut. Kjo çështje merr rëndësi edhe më të madhe në këtë procedurë, pasi bëhet fjalë për furnizim ushqimor për kategori të ndjeshme, konkretisht fëmijë të vegjël. Në këtë kontekst çmimi anomalisht i ulët nuk është vetëm çështje ekonomike; por lidhet drejtpërdrejt me sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik. Në këto kushte kur oferta e OE Kazazi Meat sh.p.k. është qartazi anomalisht e ulët dhe nuk ekziston asnjë bazë reale për justifikimin e saj sipas nenit 93 dhe se AK ka detyrimin ligjor për ta verifikuar atë atëherë mosrefuzimi i saj përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 93 të LPP dhe nenit 82 të VKM nr. 285/2021, duke cenuar parimet themelore të barazisë, konkurrencës së ndershme dhe sigurisë së kontratës publike. Parashikohet si një kundërgargument i mundshëm që çmimet e referuara nga INSTAT i përkasin tregut me pakicë

(konsumatorit fundor), ndërsa operatori ekonomik Kazazi Meat sh.p.k. mund të pretendojë se operon me çmime shumice. Ky argument nuk qëndron: Së pari, në kuadër të kësaj kontrate publike nuk kemi të bëjmë me një shitje tipike me shumicë në kuptimin ekonomik të termit, pra një furnizim të vetëm në sasi të mëdha me destinacion rishitjeje. Përkundrazi, nga vetë natyra e objektit të kontratës rezulton se: furnizimi realizohet në mënyrë periodike (ditore/javore), në sasi të fragmentuara dhe të shpërndara dhe drejtpërdrejt për konsum nga përfituesit fundorë (çerdhe/kopshte). Së dyti, karakteristika thelbësore e produktit mish i freskët viçi e përjashton praktikisht mundësinë e një furnizimi të mirëfilltë me shumicë, për shkak të: afatit shumë të shkurtër të përdorimit (rreth 7 ditë); kërkesës për zinxhir të pandërprerë të temperaturës; nevojës për shpërndarje të menjëhershme dhe të kontrolluar. Kjo do të thotë se operatori nuk po kryen një shitje me shumicë në kuptimin klasik (një volum i madh i dorëzuar njëherësh), por një furnizim të vazhdueshëm, të fragmentuar dhe operacionalisht të krahasueshëm me shitjen për konsum final. Së treti, edhe në planin ekonomik, diferenca ndërmjet çmimit të shumicës dhe atij të pakicës në produkte të tilla nuk mund të justifikojë një devijim kaq ekstrem, nga rreth 1200 lek/kg në 900 lek/kg. Pra, edhe nëse merret në konsideratë një marzh i arsyeshëm tregtar, sërish: çmimi i ofertuar mbetet në mënyrë flagrante jashtë çdo logjike tregu; dhe nuk mund të justifikohet me natyrën me shumicë të kontratës. Në këto kushte, pretendimi se çmimi i ulët justifikohet nga fakti se kemi të bëjmë me shitje me shumicë: është i pabazuar në fakt (pasi kontrata nuk realizohet si shitje klasike me shumicë); dhe i pajustificuar ekonomikisht, pasi nuk shpjegon diferencën e theksuar me çmimet reale të tregut. Për rrjedhojë, ky argument nuk mund të përdoret për të rrëzuar konkluzionin se oferta e paraqitur është anomalisht e ulët në kuptim të nenit 93 të LPP”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.3. Në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.

III.3.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “.....**Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme**.....Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % MO

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së. ”.

III.3.5. Referuar pretendimeve në ankesën e paraqitur nga ankimesi, informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 634/12 prot., datë 22.05.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1169/10 prot., datë 22.05.2026, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-75738-02-10-2026, me objekt: Loti I “*Blerje mish viçi dhe mish pule*”, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 72,673,488 (*shtatëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë*) lekë pa TVSH ose 753,483.55 (*shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e pesë*) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 10.02.2026 është 96.45 lekë, zhvilluar më datë 24.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, kanë ofertuar 2 (dy) operatorë ekonomikë nga të cilët të dy janë kualifikuar pasi rezulton se përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat e tyre janë të vlefshme në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij kualifikimi KVO-ja ka aplikuar formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, dhe DST. Në rastin në fjalë janë të vlefshme 2 (dy) oferta (përfshirë këtu ofertën e shoqërisë “*Kazazi Meat*” SHPK dhe “*Argent Daci*” PF, dhe në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se **25% e fondit limit të përlogaritur;** Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimesi si dhe nga përlogaritjet e kryera nga KPP, konstatohet, se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “*Kazazi Meat*” SHPK është në vlerën prej 58.217.160 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, nuk rezulton anomalisht e ulët, pasi vlera e saj nuk është më e ulët se 25% e fondit limit të

përlllogaritur sikurse përcaktohet në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Mbi bazën e këtij kualifikimi edhe Komisioni Vlerësimit të Ofertave dhe KSHA-ja kanë aplikuar formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” PF se oferta e operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK, është anomalisht e ulët dhe për rrjedhojë duhet skualifikuar nuk qëndron, pasi në këtë procedurë prokurimi, e cila referuar fondit limit të përgjithshëm të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe përcaktimeve të Kreut II “Kufijtë Monetar në Sektorin Klasik” pika 1 të VKM-së nr. 291, datë 15.05.2024 “Për Përcaktimin e Kufijve Monetarë në Procedurat e Prokurimit Publik” të ndryshuar kjo procedurë prokurimi është mbi kufirin e lartë monetar, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 634/12, datë 22.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1169/10 prot, datë 22.05.2026 edhe verifikimeve të bëra në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), në datën 26.03.2026 janë kualifikuar ofertat e të 2 (dy) operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, ku referuar përcaktimeve të nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta e operatorit ekonomik “Kazazi Meat” SHPK nuk rezulton anomalisht e ulët dhe si rrjedhim nuk është në kushtet e përcaktimeve të nenit 93 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Argent Daci” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-75738-02-10-2026, me objekt: Loti I “Blerje mish viçi dhe mish pule”, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 72,673,488 (shtatëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e

katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 753,483.55 (shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e pesë) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 10.02.2026 është 96.45 lekë, zhvilluar më datë 24.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Argent Daci*” PF.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu